



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**KUVENDI**

**PROJEKTLIGJ**

Nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_/\_\_/2023

**PËR**

**DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.119, DATË 14.09.2014,  
“PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë,

**V E N D O S I:**

Në ligjin nr.119, datë 14.09.2014, “Për të drejtën e informimit”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

**Neni 1**

Në nenin 2, bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1, shkronja “a”, togfjalëshi “administrativ i parashikuar në legjisllacionin në fuqi për procedurat administrative” zëvendësohet me togfjalëshin “publik, sipas përkufizimit të dhënë në ligjin nr. 44 datë 30.4.2015 “Kodi i Procedurave Administrative”.

2. Pas pikës 1, shtohen pikat 1/1 dhe 1/2 me përmbajtjen si vijon:

“1/1 “E drejta e autorit” ka të njëjtin kuptim me atë të dhënë në ligjin nr. 35, datë 31.3.2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, të ndryshuar.

1/2 “Patentë” ka të njëjtin kuptim me atë të dhënë në ligjin nr. 9947, datë 7.7.2008, “Për pronësinë industriale”, të ndryshuar.”.

3. Pas pikës 3, shtohet pikat 3/1 me përmbajtjen si vijon:

“3.1 “Sekret tregtar” ka të njëjtin kuptim me atë të dhënë në ligjin nr. 9947, datë 7.7.2008, “Për pronësinë industriale”, të ndryshuar.”.

4. Në pikën 4, togfjalëshi “ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale, të ndryshuar” zëvendësohet me togfjalëshin “ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar”.

5. Pika 6, ndryshohet si më poshtë:

“6. “Koordinator për të drejtën e informimit” është nëpunësi i autoritetit publik që ushtron kompetencat sipas përcaktimeve të këtij ligji me qëllim bashkërendimin e punës për garantimin e së drejtës së informimit.”.

## Neni 2

Në nenin 4, pas pikës 2, shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

“3. Programi i Transparencës bëhet publik në faqen zyrtare në internet të autoritetit publik.”.

## Neni 3

Në nenin 6, togfjalëshi “legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale” zëvendësohet me togfjalëshin “ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar”.

## Neni 4

Në nenin 7, bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

1. Në pikën 1, shkronja “c”, togfjalëshi “ankimit të vendimit përkatës” zëvendësohet me togfjalëshin “ushtrimit të mjeteve ligjore administrative”.

2. Në pikën 1, shkronja “ë”, togfjalëshi “nr. 9643, datë 20.12.2006, “Për prokurimin publik” zëvendësohet me togfjalëshin “nr. 162, datë 23.12.2020, Për prokurimin publik” dhe pas togfjalëshit “partneritetin publik privat” shtohet togfjalëshi “i ndryshuar”.

3. Pas pikës 3, shtohet pika 4 me përmbajtjen si vijon:

“4. Informacioni sipas pikës 1 të këtij neni, publikohet i përditësuar në çdo rast që pëson ndryshime, duke shënuar edhe datën e përditësimit të fundit, sipas mënyrës së përcaktuar nga Komisioneri.”.

## Neni 5

Në nenin 8, pika 1, togfjalëshi “çdo 3 muaj” zëvendësohet me togfjalëshin “jo më pak se 1 (një) herë në muaj”.

## Neni 6

Pas nenit 9, shtohet neni 9/1 me përmbajtjen si vijon:

### “Neni 9/1

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

1. Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (“Komisioneri”) është autoriteti i pavarur përgjegjës për shqyrtimin e ankesave, monitorimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të këtij ligji.

2. Komisioneri ushtron kompetencat e mëposhtme:

a) shqyrton ankesat e personave, të cilët pretendojnë se u janë shkelur të drejtat e tyre të parashikuara në këtë ligj;

b) shqyrton ankesat e personave në lidhje me funksionimin e programeve të transparencës në autoritetet publike;

c) kryen hetim administrativ kryesisht ose me ankesë gjatë ushtrimit të kompetencave të tij;

ç) njihet dhe ka akses në informacionin dhe dokumentet, objekt ankimi, sipas këtij ligji apo që lidhen me çështjen në shqyrtim, duke përfshirë edhe informacionet e klasifikuara. Në këto raste, ai është i detyruar të zbatojë masat për ruajtjen e informacionit të klasifikuar, sipas ligjit nr. 10, datë 22.2.2023, "Për informacionin e klasifikuar";

d) ka të drejtën t'i kërkojë autoritetit të klasifikimit deklasifikimin e një informacioni të klasifikuar kur çmon që publikimi i tij diktohet nga interesa më të rëndësishme shtetërore, sesa nevoja për ta mbajtur atë të klasifikuar, në përputhje me ligjin nr. 10, datë 22.2.2023, "Për informacionin e klasifikuar". Për njohjen me informacionin të klasifikuar të NATO-s ose BE-së, zbatohen rregullat për deklasifikimin e informacionit të klasifikuar të NATO-s dhe BE-së;

dh) vendos sanksione administrative sipas parashikimeve të këtij ligji;

e) nxit transparencën e autoriteteve publike, veçanërisht duke sensibilizuar dhe informuar për çështje të së drejtës së informimit;

ë) kryen sondazhe mbi baza vjetore në lidhje me çështje të ndryshme që kanë të bëjnë me të drejtën e informimit;

f) bën rekomandime për autoritetet publike, lidhur me konceptimin dhe zbatimin e programeve institucionale të transparencës;

g) me kërkesë të gjykatës që shqyrton çështjen, parashtron mendim me shkrim për çfarëdolloj çështjeje që lidhet me të drejtën e informimit;

gj) kryen trajnime të nevojshme dhe të vazhdueshme të koordinatorëve për të drejtën e informimit, të punonjësve të autoriteteve publike, si dhe grupeve të interesit;

h) kur arrin në përfundimin se janë shkelur dispozitat e këtij ligji, njofton autoritetin publik mbi rezultatet e hetimit administrativ dhe sipas rastit, propozon marrjen e masave disiplinore ndaj nëpunësit përgjegjës.

3. Vendimet e Komisionerit publikohen në faqen zyrtare të internetit të zyrës së Komisionerit."

## Neni 7

Në nenin 10, bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

"1. Titullari i autoritetit publik cakton një prej nëpunësve si koordinator për të drejtën e informimit. Menjëherë pas caktimit ose ndryshimit të koordinatorit për të drejtën e informimit, titullari i autoritetit publik i njofton Komisionerit emrin dhe kontaktet e nëpunësit."

2. Pas pikës 2, shtohen pikat 3, 4, 5 dhe 6 me përmbajtjen si vijon:

"3. Gjatë zhvillimit të procedurës disiplinore ndaj nëpunësit të caktuar si koordinator për të drejtën e informimit për shkelje të dispozitave të këtij ligji, autoriteti

publik kërkon mendimin e Komisionerit mbi çështjen. Në vendimin përfundimtar, autoriteti publik arsyeton edhe mbi pranimin ose refuzimin e mendimit të Komisionerit.

4. Nëpunësi i caktuar sipas pikës 1, të këtij neni, përveç pagës mujore të pozicionit në të cilin është emëruar, përfiton edhe një shtesë për natyrë të veçantë pune që shpërblen punën e tij si koordinator për të drejtën e informimit. Shtesa për natyrë të veçantë pune përfitohet vetëm gjatë kohës që nëpunësi kryen edhe detyrat shtesë si koordinator për të drejtën e informimit.

5. Këshilli i Ministrave përcakton me vendim masën e shtesës për natyrë të veçantë pune dhe kriteret për përcaktimin e saj, për koordinatorët e autoriteteve publike, struktura dhe niveli i pagave të nëpunësve të të cilëve, përcaktohen nga Këshilli i Ministrave, sipas legjislacionit në fuqi.

6. Shtesa sipas pikës 4 të këtij neni, për koordinatorët e autoriteteve publike, struktura dhe niveli i pagave të nëpunësve të të cilëve nuk përcaktohet nga Këshilli i Ministrave, përcaktohet nga organi që sipas legjislacionit në fuqi, përcakton strukturën dhe nivelin e pagave për nëpunësit e atyre autoriteteve.”.

### **Neni 8**

Në nenin 11, pas pikës 5, shtohet pika 6 me përmbajtjen si vijon:

“6. Përjashtimisht, kërkesat për njohjen me informacionin arkivor të ruajtur në arkivat e përhershëm, trajtohen në përputhje me ligjin nr. 9154, datë 6.11.2003 “Për arkivat.”.

### **Neni 9**

Në nenin 13, pika 4, togfjalëshi “nr. 10 039, datë 22.12.2008, “Për ndihmën juridike”, të ndryshuar” zëvendësohet me togfjalëshin “nr. 111, datë 14.12.2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”.

### **Neni 10**

Në nenin 15, pika 5, togfjalëshi “të çdo lloji” zëvendësohet me togfjalëshin “të ruajtur në arkivat në veprim”.

### **Neni 11**

Në nenin 17, pika 5 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në fjalinë e parë, fjala “refuzohet” zëvendësohet me fjalën “kufizohet”.
2. Në fjalinë e dytë, togfjalëshi “nr. 8457, datë 11.2.1999, “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror””, të ndryshuar” zëvendësohet me togfjalëshin “ligjit nr. 10, datë 22.2.2023, “Për informacionin e klasifikuar”.

### **Neni 12**

Në nenin 18, pika 2 bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

1. Në shkronjën “a” vlera “150 000” zëvendësohet me vlerën “50 000”.

2. Në shkronjën "c" togfjalëshi "në pikën 1, të nenit 5" zëvendësohet me togfjalëshin "në nenin 5".

3. Pas shkronjës "ç", shtohet shkronja "ç/1" me përmbajtjen si vijon:

"ç/1 mos publikimi i akteve brenda afatit të përcaktuar në pikën 3, të nenit 7 dhe mos përditësimi i kategorive të informacionit të programit institucional të transparencës sipas pikës 4, të nenit 7, të këtij ligji, dënohet me 25 000 deri në 50 000 lekë;"

4. Në shkronjën "d" vlera "50 000" zëvendësohet me vlerën "25 000";

5. Në shkronjën "dh" vlera "150 000" zëvendësohet me vlerën "50 000".

6. Në shkronjën "e" vlera "150 000" zëvendësohet me vlerën "50 000".

7. Në shkronjën "ë" vlera "150 000" zëvendësohet me vlerën "50 000".

8. Në shkronjën "f" vlera "150 000" zëvendësohet me vlerën "50 000".

9. Në shkronjën "j" vlera "150 000" zëvendësohet me vlerën "25 000".

10. Në shkronjën "ll" pas fjalës "zyrtare" shtohet togfjalëshi "fshehja ose çdo veprim apo mosveprim tjetër".

11. Pas shkronjës "ll" shtohen shkronjat "m", "n", "nj" dhe "o" me përmbajtjen si vijon:

m) mos njoftimi i kërkuesit për procedurën e rishikimit, mos arsyetimi i vendimit, ose mos njoftimi i vendimit përfundimtar të autoritetit publik, sipas pikës 5 të nenit 17 të këtij ligji, dënohet me 50 000 deri në 150 000 lekë.

n) mos caktimi i koordinatorit nga titullari i autoritetit publik ose mos njoftimi pranë Komisionerit mbi këtë caktim, sipas dispozitave të pikës 1, neni 10 dënohet me 50 000 deri në 100 000 lekë.

nj) kryerja e veprimeve ose mosveprimeve, që mund të dëntojnë rezultatin e procedurës administrative për shqyrtimin e ankesave apo të procedurës së konstatimit, shqyrtimit, ankimit dhe ekzekutimit të kundërvajtjeve administrative ose që mund të pengojnë konkluzionin e drejtë ose të rregullt të tyre, dënohet me 50 000 deri në 300 000 lekë;

o) mos zbatimi i vendimit të Komisionerit kur ka urdhëruar dhënien e informacionit të kërkuar, në mënyrë të plotë ose të pjesshme, sipas përcaktimeve të pikës 6/1, të nenit 24, këtij ligji, dënohet me 150 000 deri në 300 000 lekë."

### Neni 13

Në nenin 19, bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

1. Në pikën 1, pas shkronjës "ç", shtohet shkronja "ç/1" dhe pas shkronjës "h" shtohen shkronjat "gj", "m", "n", "nj" dhe "o".

2. Pika 2, ndryshohet si më poshtë:

"2. Në përputhje me parashikimet ligjit nr. 44 datë 30.4.2015 "Kodi i Procedurave Administrative", titullari i autoritetit publik mund të delegojë kompetencën e tij për ushtrimin e funksioneve të parashikuara në pikën 1, të nenit 4, pikat 1 dhe 2, të nenit 5, pikën 4 të nenit 7, pikat 1 dhe 2, të nenit 13, të këtij ligji, te nëpunësi më i lartë të autoritetit publik. Në këtë rast, nëpunësi të cilit i është deleguar kompetenca, mban përgjegjësi për shkeljet administrative të parashikuara në pikën 1 të këtij neni."

3. Pika 3, ndryshohet si më poshtë:

"3. Koordinatori për të drejtën e informimit ka përgjegjësi administrative për shkeljet administrative të parashikuara në shkronjat "d" dhe "e", të pikës 2, të nenit 18, të këtij ligji."

4. Pika 4, ndryshohet si më poshtë:

"4. Çdo person përgjegjës, i cili me veprimet ose mosveprimet e tij shkel dispozitat e këtij ligji, ka përgjegjësi administrative për kundërvajtjet administrative të parashikuara në shkronjat "a", "dh", "ë", "f", "g", "i", "j", "k", "l", "ll" dhe "nj" të pikës 2, të nenit 18, të këtij ligji."

#### Neni 14

Në nenin 21, pika 3, togfjalëshi "shkronjat "l" dhe "ll", të pikës 2" zëvendësohet me togfjalëshin "pikën 2".

#### Neni 15

Në nenin 24, bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

1. Në pikën 5, shkronja "b" shtohet togfjalëshi "dhe sipas rastit, propozimin për të deklasifikuar informacion."

2. Në pikën 6, togfjalëshi "përpara mbarimit të" zëvendësohet me togfjalëshin "brenda afatit".

3. Pas pikës 6, shtohet pika 6/1 me këtë përmbajtje:

"6/1. Autoriteti publik është i detyruar të zbatojë vendimin e Komisionerit kur ka urdhëruar dhënie të informacionit të kërkuar, në mënyrë të plotë ose të pjesshme, me përjashtim të rastit kur gjykata vendos pezullimin e zbatimit të tij."

#### Neni 16

Pas nenit 24 shtohet neni 24/1 me këtë përmbajtje:

##### "Neni 24/1

##### Detyrimi për bashkëpunim

1. Autoritetet publike bashkëpunojnë me Komisionerin duke i siguruar të gjithë informacionin që ai kërkon për përmbushjen e detyrave.

2. Autoritetet publike raportojnë çdo vit, jo më vonë se data 15 e muajit shkurt të vitit pasardhës, pranë Komisionerit lidhur me veprimtarinë për zbatimin e kërkesave të këtij ligji, sipas formatit të miratuar nga Komisioneri."

#### Neni 17

##### Aktet nënligjore

Ngarkohet Këshilli i Ministrave për nxjerrjen brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të aktit nënligjor në zbatim të pikës 5, të nenit 10, të ligjit.

#### Neni 18

Ky ligj hyn në faqë 15 ditë pas botimit në "Fletoren zyrtare".

**KRYETARI**

**LINDITA NIKOLLA**





## RELACION

### PËR PROJEKTLIGJIN

#### PËR

#### PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 119/2014 "PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT"

#### **I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN**

Projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 119, datë 14.09.2014 "Për të drejtën e informimit", (në vijim "projektligji"), ka për qëllim të përmirësojë dhe forcojë rregullat dhe procedurat e legjislacionit aktual për të drejtën e informimit, duke pasur në fokus nga njëra anë interesin e qytetarëve për të ushtruar të drejtën për informim lidhur me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike dhe, nga ana tjetër, rritjen e transparencës dhe llogaridhënies së autoriteteve publike.

Projektligji ka si qëllim shmangien e vakumit ligjor që mund të krijohet si pasojë e hartimit të legjislacionit të ri në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale. Me propozimin e ekspertëve të projektit të binjakëzimit që asistuan në hartimin e projektligjit, të përafruar me Rregulloren Evropiane për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim "GDPR") dhe Direktivën e Policisë, kompetencat e Komisionerit në fushën e të drejtës për informim, të parashikuar në nenin 31/1 të ligjit aktual për mbrojtjen e të dhënave personale, nuk do të jenë pjesë e ligjit të ri, por të ligjit nr. 119, datë 14.09.2014 "Për të drejtën e informimit". Ky propozim u mbështet edhe nga Zyra e Komisionerit dhe Ministria e Drejtësisë, për shkak se nga zbatimi në praktikë është konstatuar se ka patur problematika lidhur me identifikimin e kompetencave të Komisionerit në fushën e të drejtës për informim.

Gjithashtu, shtesat dhe ndryshimet e propozuara synojnë të përmirësojnë legjislacionin ekzistues, duke u bazuar në problematikat e hasura gjatë zbatimit të deritanishëm të ligjit duke marrë në konsideratë edhe sugjerimet dhe propozimet e vazhdueshme të ardhura nga shoqëria civile dhe qytetarët. Ndryshimet ligjore ofrojnë zgjidhje më optimale në njohjen me informacionin publik, një sjellje më të përgjegjshme të administratës publike me qëllim rritjen

e transparencës, reduktimin e hapësirave për korrupsion dhe rritjen e besimit të publikut në administratën publike.

Objektivat e këtij projektligji janë rritja e transparencës dhe llogaridhënieve së administratës publike, rregullimi i përgjegjësisë së personave të cilët bëhen shkak për mosdhënieve e përgjigjeve për kërkesat për informacion, rritja e përgjegjshmërisë së nëpunësve të administratës publike dhe ndërgjegjësimi i tyre për zbatimin e ligjit, si dhe mbrojtja e fuqizimi i koordinatorit për të drejtën e informimit gjatë ushtrimit të detyrës.

## **II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE**

Ky projektligj është parashikuar në Programin e Përgjithshëm Analitik të Projektakteve që i paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë katërmujorit të parë të vitit 2023.

Projektligji nuk lidhet drejtpërdrejtë me Programin Politik të Këshillit të Ministrave apo dokumente të tjera strategjike, por është në përputhje me vizionin dhe objektivat e Këshillit të Ministrave për respektimin e të drejtave të njeriut dhe rritjen e transparencës dhe llogaridhënieve së administratës publike, si dhe me angazhimin për të përmbushur rekomandimet dhe sugjerimet e organizatave ndërkombëtare, shoqërisë civile, si dhe komunitetit të biznesit për rritjen e transparencës.

## **III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME**

1. Komisioneri dhe Ministria e Drejtësisë janë në procesin e hartimit dhe dërgimit për miratim të një ligji të ri për mbrojtjen e të dhënave personale, për të përafuar legjislacionin e BE-së në këtë fushë, i cili parashikon shfuqizimin në tërësi të ligjit aktual për mbrojtjen e të dhënave personale. Si pasojë, argumenti kryesor mbi ndërmarrjen e nismës për ndryshime në ligjin për të drejtën e informimit lidhet me nevojën për të shmangur vakumin ligjor që rrezikon të krijohet me shfuqizimin e ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të

dhënave personale", i ndryshuar, në të cilin aktualisht janë të parashikuara kompetencat e Komisionerit në lidhje me të drejtën e informimit.

Me propozimin e ekspertëve të projektit të binjakëzimit që asistuan në hartimin e projektligjit, kompetencat e Komisionerit në fushën e të drejtës për informim, të parashikuar në nenin 31/1, të ligjit aktual për mbrojtjen e të dhënave personale, nuk do të jenë pjesë e ligjit të ri, por duhet të parashikohen në ligjin nr. 119, datë 14.09.2014 "Për të drejtën e informimit".

Për këtë qëllim është parashikuar që në ligj të shtohet neni 9/1, ku parashikohen kompetencat e Komisionerit, në përputhje me kompetencat e parashikuara në ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar. Gjithashtu, janë dy kompetenca të shtuara që lidhen me trajnimet e koordinatorëve për të drejtën e informimit, të punonjësve të autoriteteve publike, si dhe grupeve të interesit, si dhe njoftimin e autoritetit publik mbi rezultatet e hetimit administrativ dhe sipas rastit, propozimin e marrjes së masave disiplinore ndaj nëpunësit përgjegjës, kur arrin në përfundimin se janë shkelur dispozitat e ligjit për të drejtën e informimit.

2. Argumentet e tjera lidhen me zbatimin në praktikë të ligjit dhe me përmirësimin e legjislacionit ekzistues, duke u bazuar në problematikat e hasura gjatë implementimit të deritanishëm të ligjit, duke marrë në konsideratë sugjerimet dhe propozimet e vazhdueshme të ardhura nga shoqëria civile dhe qytetarët. Projektligji ka si qëllim ofrimin e zgjidhjeve më optimale në njohjen me informacionin publik, një sjellje më të përgjegjshme të administratës publike dhe për rrjedhim, reduktimin e hapësirave për korrupsion dhe rritjen e besimit të publikut tek autoritetet publike.

3. Një nga problematikat më të mprehta të dispozitave aktuale është ngarkimi me përgjegjësi për shkeljen e ligjit, sa i takon trajtimin të kërkesave për informim, vetëm të koordinatorit për të drejtën e informimit. Me përjashtim të rasteve të dëmtimit ose shkatërrimit të dokumenteve zyrtare, me qëllim shmangien e së drejtës për informim, si dhe moszbardhjes së dokumenteve zyrtare, në kundërshtim me rregullat në fuqi, me qëllim pengimin e ushtrimit të së drejtës për informim, për të cilat mban përgjegjësi personi përgjegjës, në të gjitha rastet e tjera përgjegjësia i ngarkohet koordinatorit.

Në praktikë, gjatë inspektimeve të kryera nga Komisioneri është konstatuar se përgjegjësia për mosdhënien e informacionit nuk ka qenë e drejtpërdrejtë e

koordinatorit. Pra, pavarësisht se koordinatori përmbush kompetencat e tij dhe për shkaqe të pavarura nga vullneti apo veprimet/mosveprimet e tij, sipas dispozitave aktuale, ngarkohet me përgjegjësi administrative për mosdhënien e informacionit. Për këtë qëllim në ligj janë kryer disa ndërhyrje të cilat synojnë që të përcaktojnë në mënyrë të saktë rastet për të cilat mban përgjegjësi koordinatori për të drejtën e informimit dhe rastet për të cilat mban përgjegjësi titullari i autoritetit publik. Ndërkohë për të gjitha rastet e tjera të parashikuara në ligj, përgjegjësi do të mbajë personi përgjegjës, i cili përmes veprimeve apo mosveprimeve të tij ka sjellë si pasojë shkeljen e dispozitave.

Në këtë kuptim, koordinatori për të drejtën e informimit dhe titullari i autoritetit publik do të mbajnë përgjegjësi jo vetëm për kundravajtjet për të cilat ngarkohen me përgjegjësi administrative shprehimisht, por edhe për kundravajtjet e tjera për të cilat provohet se shkelja ka ardhur si pasojë e veprimeve ose mosveprimeve të tyre. Pra, në rrethin e personave përgjegjës do të përfshihen koordinatori, titullari i autoritetit publik, si dhe çdo person tjetër i cili me veprimet ose mosveprimet e tij ka sjellë si pasojë shkeljen e dispozitave të ligjit.

4. Nga ana tjetër, me propozimin e Komisionerit dhe dakordësinë e Ministrisë së Drejtësisë, janë rishikuar kufijtë minimalë të gjobave që vendosen për shkeljen e dispozitave të këtij ligji. Ky rishikim diktohet nga mungesa e proporcionalitetit ndërmjet masës së gjobës që aktualisht aplikohet ndaj koordinatorit për të drejtën e informimit ose personit përgjegjës, në raport me pagën e tij. Në disa raste, të zbatuara edhe në praktikë, kufiri minimal i masës së gjobës ka rezultuar të jetë disa-fish më i madh se paga e nëpunësve publik dhe vendosja e një mase të tillë gjobe i shkakton një dëm të konsiderueshëm kushteve ekonomike dhe të jetesës së nëpunësit. Dënimi administrativ ka si synim kryesor parandalimin e shkeljes së ligjit, si dhe ndërgjegjësimin e shkelësit dhe jo thjesht dënimin e tij.

Për këto arsye masa e gjobës është rishikuar, megjithatë, është treguar kujdes që nga njëra anë të sigurohet proporcionaliteti duke ulur kufirin minimal të gjobës dhe, nga ana tjetër, të garantohet dhënia e një dënimi proporcional në raport me shkeljen, duke mos ndryshuar kufirin maksimal të vlerës së gjobës.

Në lidhje me këtë çështje vlen të sillet në vëmendje vendimi nr. 33/2016 i Gjykatës Kushtetuese i cili ka trajtuar respektimin e parimit të proporcionalitetit në përcaktimin e masës së gjobës, si dënim administrativ. Sipas Gjykatës, duhet treguar kujdes në përcaktimin e masës së gjobës në mënyrë që ato të jenë proporcionale, pra të përshtatshme për shkeljen, duhet të jenë në përputhje me objektivat legjitime e të rëndësishëm dhe nuk duhet të kufizojnë personin më shumë se është e nevojshme për të arritur këto objektiva.

Për analizimin e kriterëve të mësipërme vlen të vlerësohen krahasohen kufiri minimal i gjobës sipas ligjit aktual me të ardhurat e disa nëpunësve të bashkive dhe këshillat e qarqeve si autoritete publike. Masa më e ulët e gjobës e parashikuar nga ligji aktual është 25 000 lekë, ndërsa për shkeljet e tjera kufiri minimal i masës së gjobës është 50 000 lekë ose 150 000 lekë. Ndërkohë, për disa pozicione pune në bashki dhe këshilla qarqesh paga e nëpunësit fillon nga 24 000 lekë dhe 24 600 lekë. Sipas parashikimeve aktuale masa e gjobës është 1 000 lekë më e lartë sesa paga mujore e nëpunësve në rastin e gjobës me vlerë 25 000 lekë dhe më shumë se dyfishi ose gjashtëfishi i pagës mujore në rastin e gjobave me vlerë 50 000 lekë ose 150 000 lekë.

5. Duke qenë se marrëdhëniet e punës në disa autoritete publike nuk rregullohen sipas dispozitave të legjislacionit të nëpunësit civil, por sipas dispozitave të Kodit të Punës nevojitet që të ndërhyhet në dispozitën që parashikon përkufizimet e termave me qëllim që të përcaktohet qartë se cili është nëpunësi i autoritetit publik i cili mund të caktohet si koordinator për të drejtën e informimit.

6. Për të shmangur çdo vonesë nga ana e autoritetit publik në publikimin e informacionit pjesë të Programit të Transparencës, projektligji parashikon detyrimin për përditësimin e informacionit çdo herë që pëson ndryshime, duke treguar gjithashtu datën e përditësimit të fundit. Kjo është një masë që synon rritjen e transparencës së organeve publike duke i siguruar publikut informacion të përditësuar dhe që i shërben qëllimit që ka në thelb e drejta për informim.

Vërehet se disa nga autoritetet publike kanë përmbushur detyrimin për të publikuar informacionin në programin e tyre të transparencës, por ky informacion nuk i përgjigjet realitetit për shkak të ndryshimeve që ka pësuar. Përmes shtimit të pikës 4 në nenit 7, sanksionohet me ligj detyrimi për të

publikuar informacionin e përditësuar, si dhe për të shënuar datën e përditësimit të fundit. Shënimi i datës i shërben nga njëra anë, informimit të publikut, por nga ana tjetër, edhe ushtrimit të kontrollit nga ana e Komisionerit apo edhe vetë publikut ndaj informacionit që publikon autoriteti publik. Në këtë mënyrë rritet edhe përgjegjshmëria e autoriteteve publike duke i vendosur para detyrimit për të publikuar informacionin, si dhe përpara presionit pozitiv që ushtron publiku ndaj tyre. Mënyra e përditësimit të informacionit do të përcaktohet nga ana e Komisionerit në mënyrë që të gjenden zgjidhjet optimale duke u mbështetur në programet e miratura të transparencës. Për shkak të rëndësisë që paraqet në kuadër të së drejtës për informim, mospërditësimi i informacionit në Programin e Transparencës përbën shkak për vendosjen e një sanksioni administrativ që do të aplikohet ndaj titullarit.

Gjithashtu, është parashikuar shprehimisht detyrimi që autoritetet publike të publikojnë Programin e Transparencës në faqen e tyre zyrtare të internetit me qëllim lehtësimin e aksesit në informacion.

7. Përmes parashikimeve të projektligjit janë rregulluar edhe disa çështje të cilat lidhen me koordinatorin për të drejtën e informimit. Në praktikë është vërejtur se autoritetet publike ndryshojnë koordinatorin duke caktuar nëpunës të tjerë si koordinator, por nuk njoftojnë Komisionerin mbi këtë ndryshim. Kjo problematikë ndikon në mbarëvajtjen e punës dhe ushtrimin e kompetencave të Komisionerit, pasi në shumë raste veprimtaria e tij është e lidhur drejtpërdrejtë me koordinatorin e autoritetit publik, i cili shërben edhe si pikë kontakti e autoritetit.

Në mënyrë që të adresohet problematika e hasur deri më tani, është parashikuar detyrimi që do të mbartin autoritetet për të njoftuar Komisionerin jo vetëm për caktimin e koordinatorit për të drejtën e informimit, por edhe për ndryshimin e tij. Nisur nga situata e deritanishme, si dhe nga rëndësia dhe roli që luan koordinatori për respektimin e të drejtës për informim, është konsideruar e nevojshme që të parashikohet si shkelje e ligjit mospërbushja e detyrimit për njoftimin e Komisionerit për caktimin ose ndryshimin e koordinatorit për të drejtën e informimit, për të cilën do të aplikohet edhe sanksioni administrativ përkatës.

8. Regjistri i Kërkesave dhe Përgjigjeve përbën një nga instrumentet kryesore me anë të të cilit promovohet transparenca e autoriteteve publike, si dhe garantohet e drejta për informim e publikut. Detyrimi për publikimin e këtij regjistri çdo 3 muaj vlerësohet se nuk i shërben në mënyrë efektive qëllimit për të cilin është krijuar. Njohja me informacionin që i është dhënë më parë kërkuarëve të tjerë nuk garantohet në mënyrë efektive nëse ky informacion publikohet në periudha 3-mujore.

Interesi i publikut, por edhe i autoriteteve publike, është që të marrë informacionin për çështje të njëjta apo të ngjashme, sa më shpejt të jetë e mundur dhe pa pasur nevojë të dërgojë një kërkesë për informim. Nëse regjistri publikohet në periudha më të shkurtra (1-mujore), do të rritet niveli i transparencës dhe informacionit që i vihet në dispozicion qytetarëve, duke ndikuar kështu në uljen eventuale të numrit të kërkesave për informacion. Nga ana tjetër, pavarësisht se publikimi i regjistrit jo më pak se njëherë në muaj do të sjellë një rritje të ngarkesës së punës së koordinatorit për të drejtën për informim, vlerësohet se kjo rritje është e lehtë dhe nuk do të ketë ndonjë ndikim të tepërt në punën e tij.

9. Në ligj janë kryer edhe disa ndryshime që synojnë zgjidhjen e problematikave në lidhje me ushtrimin e së drejtës për informim për dokumentet arkivore, parë këto në raport me legjislacionin në fuqi për arkivat. Dispozitat në fuqi parashikojnë që çdo autoritet publik t'i vendosë në dispozicion qytetarit dokumentet që kërkon, përfshirë edhe informacionin arkivor të çdo lloji. Vendosja në dispozicion e dokumentacionit është lehtësisht e realizueshme në një arkiv në veprim, por është thuajse e pamundur në një arkiv të përhershëm që mbledh dokumentacionin e të gjithë fondkrijuesve. Kjo, pasi arkivi i përhershëm administron dhjetra kilometra linearë dokumentacion, me qindra milionë fletë dhe angazhimi i punonjësve të tij për realizimin e kërkesës së qytetarit është absolutisht i pamundur.

Për këtë arsye, legjislacioni arkivor i njeh subjekteve të drejtën e shfrytëzimit, pra qasjen e lirë të tyre në informacion nëpërmjet studimit në sallën e studimit, duke përzgjedhur personalisht njësitë e ruajtjes arkivore që dëshirojnë të studiojnë, pasi ka konsultuar inventarët që janë lirisht të qasshme. E drejta e shfrytëzimit e dokumenteve arkivore në arkivin historik realizon rrjedhimisht të drejtën për informim, që në kushte të tjera do të ishte e parrealizueshme.

Në këtë kuadër, në ligj bëhen dy ndryshime. Ndryshimi i parë bëhet në nenin 11, ku shtohet pika 6, sipas së cilës, përjashtimisht, kërkesat për njohjen me informacionin arkivor të ruajtur në arkivat e përhershëm, trajtohen në përputhje me parashikimet e legjislacionin në fuqi për arkivat. Ndërsa ndryshimi i dytë kryhet në pikën 5, të nenit 15, në mënyrë që afati 10 ditor për vendosjen në dispozicion të dokumentacionit të jetë si detyrim për dokumentacionin që ruhet në arkivat në veprim. Sa i përket dokumentacionit që ruhet në arkivat e përhershme, autoriteti publik, në këtë rast arkivi i përhershëm, do të duhet që brenda këtij afati të njoftojë kërkuuesin mbi të drejtën e tij për shfrytëzimin e dokumentacionit

10. Pavarësisht rishikimit me ulje të kufirit minimal të gjobës që do të aplikohet ndaj personave përgjegjës, në funksion të rritjes së përgjegjshmërisë së nëpunësve të autoriteteve publike, si dhe marrjes së masave për shmangien e shkeljeve të ligjit, është parashikuar që në rastet kur Komisioneri arrin në përfundimin se janë shkelur dispozitat e ligjit për të drejtën e informimit, të njoftojë eprorin direkt ose komisionin disiplinor mbi rezultatet e hetimit administrativ dhe sipas rastit, të propozojë marrjen e masave disiplinore ndaj nëpunësit përgjegjës.

Kjo kompetencë është shoqëruar me një ndryshim në pikën 3, të nenit 21, sipas të cilës bëhet e mundur që Komisioneri të ketë të drejtën të propozojë marrjen e masave disiplinore ndaj personave përgjegjës, për të gjitha shkeljet e parashikuara në pikën 2, të nenit 18.

Ky parashikim përbën një risi për shkak se aktualisht, Komisioneri mund të propozojë marrjen e masave disiplinore vetëm ndaj personave përgjegjës për shkeljet e parashikuara në shkronjat "I" dhe "II", të pikës 2, të nenit 18. Në këtë mënyrë, rast pas rasti dhe në varësi të saktësisë së kryer dhe pasojave që kanë ardhur prej saj, krahas vendosjes së gjobës, Komisioneri do të mund të propozojë marrjen e masave disiplinore, si një praktikë e ngjashme me parashikimet e ligjit nr. 107/2021 "Për bashkëqeverisjen".

11. Në rast se ndaj nëpunësit të caktuar si koordinator për të drejtën e informimit do të zhvillohet procedimi disiplinor për shkelje të dispozitave të këtij ligji, autoriteti publik tashmë detyrohet të kërkojë mendimin e

Relacion shpjegues për projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin 119/2014 "Për të drejtën e informimit".



Komisionerit mbi çështjen. Shtimi i kësaj dispozite i shërben garantimit të marrjes së një vendimi të drejtë, marrjes së një mendimi të specializuar nga ana e institucionit që mbikëqyr zbatimin e ligjit për të drejtën e informimit, si dhe mbrojtjes së koordinorit nga procedimi disiplinor në kundërshtim me ligjin. Këtë mendim organi disiplinor do të jetë i detyruar t'a pasqyrojë në vendimin përfundimtar të procedurës disiplinore duke arsyetuar e dhënë shpjegime edhe mbi pranimin ose refuzimin e tij.

12. Nëpunësi i caktuar si koordinator për të drejtën e informimit përballet me një ngarkesë të shtuar të punës së tij, për shkak se krahas punës që kryen në kuadër të përmbushjes së detyrave sipas pozicionit të tij, kryen edhe të gjitha detyrat e caktuara nga ligji për të drejtën e informimit. Megjithatë, natyra e veçantë e punës që kryen, si dhe ngarkesa e shtuar, nuk janë shoqëruar me një shpërblim të drejtë të koordinorit, çka përbën shkak edhe për demotivimin e tij. Kjo problematikë është ngritur në mënyrë të vazhdueshme edhe nga koordinorët për të drejtën e informimit gjatë aktiviteteve të organizuara nga Zyra e Komisionerit.

Kjo mangësi në shpërblimin e punës së koordinorit është adresuar përmes shtimit të pikave 4, 5 dhe 6, në nenin 6 të ligjit, që parashikon se gjatë periudhës që është caktuar si koordinator për të drejtën e informimit, nëpunësi i autoritetit publik përfiton shtesë për natyrë të veçantë pune mbi pagën mujore. Këshilli i Ministrave përcakton me vendim masën e shtesës për natyrë të veçantë pune dhe kriteret për përcaktimin e saj, për koordinorët e autoriteteve publike, struktura dhe niveli i pagave të nëpunësve të të cilëve, përcaktohen nga Këshilli i Ministrave, sipas legjislacionit në fuqi. Ndërkohë për koordinorët e autoriteteve publike, struktura dhe niveli i pagave të nëpunësve të të cilëve nuk përcaktohet nga Këshilli i Ministrave, shtesa do të përcaktohet nga organi që sipas legjislacionit në fuqi, përcakton strukturën dhe nivelin e pagave për nëpunësit e atyre autoriteteve.”.

Në këtë mënyrë adresohet edhe një nga kërkesat kryesore të koordinorëve për të drejtën e informimit, si dhe rritet motivimi i tyre për kryerjen e detyrave.

13. Bashkëpunimi i autoritetit publik me Komisionerin përbën një nga aspektet më të rëndësishme në drejtim të garantimit së drejtës për informim dhe përmbushjen e qëllimit të ligjit. Për shkak të rëndësisë që mbart ky

bashkëpunim është shtuar neni 24/1, i cili parashikon që autoritetet publike të bashkëpunojnë me Komisionerin duke i siguruar të gjithë informacionin që ai kërkon për përmbushjen e detyrave të tij. Nga ana tjetër, ky bashkëpunim është i domosdoshëm dhe ka një rëndësi të veçantë për zhvillimin e procedurës për shqyrtimin e ankesave të paraqitura pranë Komisionerit, si dhe të procedurës së konstatimit, shqyrtimit, ankimit dhe ekzekutimit të kundërvajtjeve administrative.

Kryerja e këtyre dy procedurave kërkon në mënyrë të pashmangshme që titullari i autoritetit publik, si dhe çdo person përgjegjës të ofrojë të gjithë informacionin dhe mbështetjen që i duhet Komisionerit për të ushtruar detyrat dhe përmbushjen e kompetencave të tij. Me qëllim shmangien e rasteve që janë evidentuar në praktikë, ku zhvillimi i procedurave administrative nga ana e Komisionerit ka qenë i pamundur pikërisht për shkak të veprimeve ose mosveprimeve që dëmtojnë rezultatin e procedurës ose pengojnë konkluzionin e drejtë ose të rregullt të saj, është shtuar shkronja “nj”, në pikën 2, të nenit 18, e cila parashikon dënimin me gjobë në masën 50 000 deri në 300 000 lekë që do të aplikohet ndaj titullarit të autoritetit publik ose personit përgjegjës, në varësi të subjektit që shkel këtë detyrim.

Nga ana tjetër, në mënyrë që Komisioneri të ushtrojë në mënyrë të duhur kompetencat e tij, nevojitet që të ketë një panoramë të qartë dhe të saktë të gjendjes së përmbushjes së detyrimeve që burojnë nga ligji për të drejtën e informimit. Për këtë qëllim, autoritetet publike ngarkohen me detyrimin që të raportojnë çdo vit, jo më vonë se data 15 e muajit shkurt të vitit pasardhës, pranë Komisionerit lidhur me veprimtarinë për zbatimin e kërkesave të këtij ligji sipas formatit të miratuar nga Komisioneri.

Kjo dispozitë i shërben kontrollit që Komisioneri ushtron mbi autoritetet publike, evidentimit të problematikave për zbatimin e ligjit, si dhe rritjes së përgjegjshmërisë së autoriteteve publike. Gjithashtu, këto statistika do t'i shërbejnë punës së Komisionerit për evidentimin e nevojave për të ndërhyrë, në rastet që do të shfaqen çështje që kërkojnë ndryshime të praktikës ose legjislacionit.

14. Një nga problematikat e ngritura nga Zyra e Komisionerit dhe organizatat e shoqërisë civile është edhe moszbatimi i vendimeve të Komisionerit. Me qëllim

shmangien e këtyre rasteve dhe respektimin e të drejtës për informim është shtuar shkronja “o” në pikën 2, të nenit 18, sipas së cilës mos zbatimi i vendimeve të Komisionerit sipas parashikimeve të këtij ligji, do të dënohet me gjobë në masën 150 000 deri në 300 000 lekë, sanksion i cili do të aplikohet ndaj titullarit të institucionit.

#### **IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR**

Projektligji është tërësisht në përputhje me nenin 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, si dhe garanton respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të individit.

Në përputhje me nenin 26 të ligjit nr. 9000, datë 30.01.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, Ministri i Drejtësisë është autoriteti i deleguar për propozimin e këtij projektligji, ndaj edhe nisma e propozuar, paraqitet si një iniciativë për shqyrtim dhe miratim nga Këshilli i Ministrave, në mbështetje të neneve 81, pika 1, dhe 100, të Kushtetutës.

#### **V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)**

Projektakti nuk synon përafrimin me *acquis* të Bashkimit Evropian, ndaj edhe nuk ka vlerësim të shkallës së përafrimit.

#### **VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT**

Projektligji përmban gjithsej 18 nene.

Në nenin e parë parashikohen ndryshimet që bëhen në nenin 2 të ligjit të cilat lidhen me përkufizimin e autoritetit publik, si dhe termave të tjera që përdor ligji, si “e drejta e autorit”, “patenta”, “sekreti tregtar”, si dhe “koordinator për të drejtën e informimit”.

Neni 2 parashikon shtimin e pikës 3, në nenin 4 të ligjit, sipas së cilës parashikohet detyrimi që Programi i Transparencës të bëhet publik në faqen zyrtare në internet të autoritetit publik.

Sipas nenit 3, parashikohet zëvendësim i togfjalëshit “legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale” me togfjalëshin “ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar”, në përputhje me pikën 3, të nenit 32, të udhëzimit nr. 6, datë 29.4.2022 “Për përcaktimin e metodologjisë së unifikuar për hartimin e akteve normative”.

Në neni 4 parashikohen disa ndryshime të natyrës teknike në nenin 7, si dhe detyrimi për përditësimin e informacionit që publikohet pa pagesë dhe shënimin e datës së përditësimit të fundit.

Neni 5 parashikon zëvendësimin e togfjalëshit “çdo 3 muaj” me togfjalëshin “jo më pak se 1 (një) herë në muaj”, në pikën 1, të nenit 8, në mënyrë që Regjistri i Kërkesave dhe Përgjigjeve të Publikohet të paktën një herë muaj.

Neni 6 sjell shtimin e nenit 9/1 që parashikon statusin dhe kompetencat Komisionerit, si dhe që vendimet e tij publikohen në faqen zyrtare të internetit.

Në nenin 7 parashikohen disa ndryshime dhe shtesa në nenin 10 të ligjit. Konkretisht, pika 1 ndryshohet me qëllim që përcaktohet detyrimi i titullarit të autoritetit publik për të caktuar një prej nëpunësve si koordinator për të drejtën e informimit, si dhe njoftimin e Komisionerit për caktimin ose ndryshimin të koordinatorit për të drejtën e informimit. Gjithashtu, në nenin 10 shtohet pika 3 e cila ka të bëjë me detyrimin e autoritetit publik që gjatë zhvillimit të procedurës disiplinore ndaj nëpunësit të caktuar si koordinator për të drejtën e informimit për shkelje të dispozitave të këtij ligji, të kërkojë mendimin e Komisionerit mbi çështjen dhe në vendimin përfundimtar të arsyetojë edhe mbi pranimin ose refuzimin e mendimit të dhënë prej tij.

Në pikat 4, 5 dhe 6 që i shtohen nenit 10, parashikohet përfitimi i një shtese për natyrë të veçantë pune mbi pagën mujore që nëpunësi i autoritetit publik do të përfitojë gjatë periudhës që është caktuar si koordinator për të drejtën e informimit, si dhe organi që do të përcaktojë këtë shtesë.

Në nenin 8 parashikohet shtimi i pikës 6, në nenin 11, sipas së cilës Përrjashtimisht, kërkesat për njohjen me informacionin arkivor të ruajtur në arkivat e përhershëm, trajtohen në përputhje me ligjin nr. 9154, datë 6.11.2003 “Për arkivat.



Neni 9 parashikohen një ndërhyrje sa i përket referencës së ligjit për ndihmën juridike të garantuar nga shteti, në mënyrë që të referohet në ligjin që është aktualisht në fuqi, pasi ligji nr. 10 039, datë 22.12.2008, "Për ndihmën juridike", është shfuqizuar tashmë.

Neni 10 parashikon ndryshimin në nenin 15 të ligjit që lidhen me njohjen me informacionin arkivor.

Në nenin 11 bëhen disa ndryshime të natyrës teknike që lidhen me referencat e jashtme në legjislacionin përkatës.

Sipas nenit 12 bëhen disa shtesa dhe ndryshime në pikën 2, të nenit 18 të ligjit të cilat kanë të bëjnë me rishikimin e masës së gjobës, si dhe me shtimin e disa kundravajtjeve të reja, në përputhje me parashikimet e ndryshimeve që do të bëhen në ligj.

Përmes nenit 13, janë bërë disa ndryshime në nenin 19 duke rikonceptuar përgjegjësinë administrative të titullarit të institucionit, koordinаторit për të drejtën e informimit dhe personit përgjegjës.

Në nenin 14, parashikohet që togfjalëshi "shkronjat "I" dhe "II", të pikës 2" zëvendësohet me togfjalëshin "pikën 2".

Në nenin 15 parashikohen disa ndryshime në nenin 24 të cilat lidhen me procedurën që zhvillon Komisioneri në kuadër të shqyrtimit të ankesave, si dhe detyrimi i autoritetit publik për të zbatuar vendimin e Komisionerit kur ky i fundit ka urdhëruar dhënien e informacionit të kërkuar, në mënyrë të plotë ose të pjesshme, me përjashtim të rastit kur gjykata vendos pezullimin e zbatimit të tij.

Neni 16 parashikon shtimin e nenit 24/1 mbi detyrimin për bashkëpunim të autoriteteve publike me Komisionerin. Sipas këtij neni autoritetet publike bashkëpunojnë me Komisionerin duke i siguruar të gjithë informacionin që ai kërkon për përmbushjen e detyrave. Gjithashtu, parashikohet që autoritetet publike të raportojnë çdo vit, jo më vonë se data 15 e muajit shkurt të vitit pasardhës, pranë Komisionerit lidhur me veprimtarinë për zbatimin e kërkesave të këtij ligji, sipas formatit të miratuar nga Komisioneri.

Neni 17 parashikon nxjerrjen e akteve nënligjore nga Këshilli i Ministrave, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Sipas nenit 18, ligji do të hyjë në fuqi 15 ditë pas botimit në "Fletoren zyrtare".

## **VII. MINISTRITË, INSTITUCIONET DHE SUBJEKTET E TJERA QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT**

Drafti fillestar i projektligjit është hartuar nga Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjes së të Dhënave Personale dhe më tej i është dërguar për ndjekje të procesit legjislativ Ministrisë së Drejtësisë, si ministria përgjegjëse për propozimin e projektligjit.

Në zbatim të ligjit nr. 146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik", Ministria e Drejtësisë publikoi në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike njoftimin paraprak.

Me anë të këtij njoftimi, Ministria e Drejtësisë ka kërkuar çdo informacion ose opinion paraprak për çdo çështje apo problematikë me të cilën qytetarët apo subjekte të tjera hasur gjatë zbatimit të ligjit për të drejtën e informimit, si dhe propozime konkrete për ndryshime në ligj me qëllim adresimin e këtyre çështjeve. Gjithashtu, janë kërkuar edhe informacione ose opinione të tjera që i shërbejnë përmirësimit të ligjit për të drejtën e informimit, garantimit të së drejtës për informim dhe rritjes së nivelit të transparencës së autoriteteve publike. Në përfundim të afatit të parashikuar nga ligji nr. 146/2014, nuk u dërguan komente përmes RENJK.

Me shkresën nr. 3678 prot., datë 04.06.2022, njoftimi paraprak i është dërguar nominalisht edhe disa prej organizatave kryesore të shoqërisë civile, si dhe atyre me fokus median dhe gazetarinë. Pas këtij njoftimi, 5 organizata të shoqërisë civile kanë dërguar opinionet dhe propozimet e tyre, të cilat janë mbajtur në konsideratë gjatë hartimit të projektligjit.

Në vijim, Ministria e Drejtësisë ka kryer ndërhyrjet e nevojshme në projektligj me qëllim sigurimin e përputhshmërisë me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi, si dhe ndërhyrje me karakter teknik.

1. Projektligji i është dërguar për mendim nëpërmjet sistemit e-akte të gjitha ministrive të linjës, si dhe Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, Departamentit të Administratës Publike, Agjencisë Shtetërore të Kadastrës dhe Agjencisë së Prokurimit Publik.

Relacion shpjegues për projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin 119/2014 "Për të drejtën e informimit".

1.1 Nga këto institucione ka shprehur dakordësinë: AKSHI, ASHK, APP, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Kulturës, Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, Ministri i Shtetit për Standardet e Shërbimeve.

1.2 **Ministri i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin** nuk ka përcjellë mendimin e tij dhe në zbatim të pikës 28, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 584/2003, “Për miratimin e rregullores së Këshillit të Ministrave”, i ndryshuar, konsiderohet se është dakord dhe pa vërejtje për projektaktin. Pjesa tjetër e ministrive kanë përcjellë komente.

1.3 **Ministria e Arsimit dhe Sportit** ka përcjellë komente të natyrës teknike duke sugjeruar riformulim të dispozitave. Në lidhje me sugjerimin që togfjalëshi “përditësimi i programit institucional të transparencës” në shkronjën “ç/l” që do t’i shtohet pikës 2, të nenit 18, të zëvendësohet me togfjalëshin “përditësimi i kategorive të informacionit që pësojnë ndryshime”, nisur nga ky koment, dispozita është riformuluar në mënyrë që ajo të jetë më jetë më e qartë dhe më i thjeshtë për t’u kuptuar dotyrimi që ka autoriteti për përditësimin e informacionit.

1.4 **Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Ministria e Brendshme** kanë sugjeruar që në nenin 8 të projektligjit, ku përcaktohet ndryshimi i pikës 5, të nenit 15 të ligjit, pas fjalëve “të ruajtur në arkivat në veprim” të shtohen fjalët “të institucioneve shtetërore, qendrore dhe vendore”, në përputhje me shkronjën “dh”, të pikës 2 të nenit 9, të ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003, “Për arkivat”.

Në lidhje me këtë çështje, Ministria e Drejtësisë, ka synuar që projektligji të jetë në harmoni të plotë me ligjin nr. 9154, datë 6.11.2003, “Për arkivat”, i cili është në proces ndryshimi dhe projektligji është publikuar në RENJK në linkun si më poshtë <http://www.konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/462>. Duke qenë se në këtë projektligj janë parashikuar ndryshime edhe të nenit 9, me qëllim shmangien e konfuzionit që mund të krijohet pas ndryshimit të tij, në projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin 119/2014 “Për të drejtën e informimit””, është përdorur vetëm termi “arkivat në veprim”. Në këtë mënyrë, nga njëra anë arrihet harmonizimi me ndryshimet e planifikuara dhe, nga ana tjetër, shmanget konfuzioni pasi termi “arkiva në veprim,” pavarësisht se ndryshimit ose jo të nenit 9, përfshin të gjitha arkivat në veprim të institucioneve shtetërore, qendrore dhe vendore.

1.5 **Ministria e Mbrojtjes** ka përcjellë komente që lidhen me kompetencat e Komisionerit, të përcaktuara në shkronjat “ç” dhe “d”, të pikës 2, të nenit 9/1 në lidhje me informacionin e klasifikuar. Sugjerimi që në shkronjën “ç” të shtohet fjalët “përfshirë rastet kur informacioni i klasifikuar “sekret shtetëror” është përfshirë apo ka pjesë nga informacione të klasifikuara nga NATO dhe BE”, si dhe në shkronjën “d” të shtohet fjalët “në rastet e përmbajtjes së informacionit të klasifikuar të NATO/BE, në interes të njohjes me informacionin, duhet të ndiqen të gjitha rregullat e njohjes me informacionin e klasifikuar të NATO-s dhe BE-së” nuk është pranuar.

Shkronja “ç” e pikës 2, të nenit 9/1 është e njëjtë me shkronjën “ç”, të nenit 31/1, të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, ku aktualisht janë të përcaktuara kompetencat e Komisionerit në fushën e mbrojtjes së të drejtës për informim.

Informacioni i klasifikuar i NATO-s dhe BE-së, përbën informacion të klasifikuar që disponohet nga institucionet shtetërore, si dhe ruhet në përputhje me ligjin nr. 10/2023, “Për informacionin e klasifikuar. Sipas pikës 2, të nenit 2 të ligjit për të drejtën e informimit, informacioni publik është çdo c dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik, pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga autoriteti publik.

Në kushtet kur sipas këtij ligji, edhe informacioni i klasifikuar përbën informacion publik, personi ka të drejtë që të kërkojë informacionin e klasifikuar të NATO-s dhe BE-së, ndërsa institucioni ka mundësinë të refuzojë dhënien e tij bazuar në kufizimet e parashikuara në nenin 17, të ligjit për të drejtën e informimit. Nëse personi paraqet ankim, Komisioneri, në kuadër të përmbushjes së kompetencave të tij për shqyrtimin e ankimit, mund të kërkojë që të njihet me informacionin në mënyrë që të kryejë një hetim të plotë administrativ dhe të marrë një vendim në lidhje me ankimin.

E drejta e njohjes me informacionin e klasifikuar nuk mund t'i kufizohet Komisionerit, vetëm për shkak se është informacion që është përfshirë apo ka pjesë nga informacione të klasifikuara nga NATO dhe BE, pasi në këtë mënyrë cenohet jo vetëm kompetenca e Komisionerit për të shqyrtuar ankimin dhe kryer hetimin administrativ, por edhe e drejta e personit për informim. Pikërisht për të garantuar balancën ndërmjet nevojës për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar dhe respektimit të së drejtës për informim, ligji ka parashikuar Komisionerin si një institucion i cili ka të drejtë të njihet me informacionin e klasifikuar dhe kur



është rasti, të njoftojë personin se e drejta e tij për informim kufizohet për shkak të parashikimeve të nenit 17.

Megjithatë, Komisioneri nuk mund të arrijë në këtë përfundim pa u njohur informacionin, për të verifikuar nëse informacioni vërtet bën pjesë në informacionin e klasifikuar të NATO-s dhe BE-së dhe nëse publikimi i tij cenon sigurinë kombëtare, sipas përkufizimit të bërë nga legjislacioni për informacionin e klasifikuar apo mbarëvajtjen e marrëdhënieve ndërkombëtare ose ndërqeveritare. Për të ushtruar këto kompetenca ligji parashikon që të zbatohen masat për ruajtjen e informacionit të klasifikuar, sipas legjislacionit në fuqi për informacionin e klasifikuar, që garantojnë mbrojtjen dhe ruajtjen edhe të informacionit të klasifikuar të NATO-s dhe BE-së.

Sa i përket sugjerimeve në lidhje me shkronjën “d”, me qëllim reflektimin e komentit është shtuar një fjalia “Për njohjen me informacionin të klasifikuar të NATO-s ose BE-së, zbatohen rregullat për deklasifikimin e informacionit të klasifikuar të NATO-s dhe BE-së”.

**1.6 Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale**, ka sugjeruar që të vijojë përcaktimi në projektligj mbi mënyrën se si shënohet data e përditësimit të fundit të programit të transparencës.

Në lidhje me këtë sugjerim sqarojmë se ligji nuk parashikon në mënyrë shteruese të gjitha informacionet që publikohen në Programin e Transparencës, por ka parashikuar kategoritë e tij në mënyrë që të sigurohet një transparencë sa më e lartë. Në të njëjtën logjikë, ligji nuk mund të parashikojë mënyrën e përditësimit të informacionit ose të shënimit të datës së përditësimit të fundit, pasi është një proces që lidhet ngushtë me kategorinë e informacionit të publikuar. Sipas formatit të shpërndarë nga Komisioneri dhe që aktualisht është publikuar në faqet e autoriteteve publike, jo gjithmonë kemi të bëjmë me publikim dokumentesh, pasi ka raste që thjesht vendoset linku përkatës (rasti i informacionit mbi prokurimet ku publikohet linku i regjistrave të prokurimit publik) ose të dhënash (siç janë të dhënat e koordinatorit për të drejtën e informimit apo të njoftimit dhe konsultimit publik). Në këto kushte, mënyra e përditësimit të informacionit është çështje që lidhet me zbatimin në praktikë të ligjit dhe përditësimi i informacionit kryhet në varësi të kategorisë së cilës informacioni i përket.

Megjithatë, në këtë proces rol të veçantë do të luajë edhe Komisioneri në kuadër të nenit 6, të ligjit për të drejtën e informimit. Në këto kushte, përmes



riformulimit të pikës 4 që shtohet në nenin 7, është lënë në vlerësimin e Komisionerit që të përcaktojë mënyrën se si do të përditësohet dhe shënohet data e përditësimit të fundit të informacionit që publikohet në programin e transparencës

Kjo ministri ka paraqitur edhe komente në lidhje me nenin 24/2, i cili pas sugjerimeve dhe komenteve të përcjella është hequr nga përmbajtja e projektligjit.

**1.7 Ministria e Turizmit dhe Mjedisit** ka sugjeruar që të parashikohet edhe përcaktimi i organit publik që miraton Programin e Transparencës, pasi në pikën 4 të ligjit 119/2014, përvec parashikimeve që lidhen me përgatitjen e Programit të Transparencës, kërkohet edhe miratimi i këtyre programeve, ndërkohë që është e paqartë se cili është organi miratues.

Në lidhje me këtë çështje sqarojmë se në zbatim të nenit 5, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale miraton dhe shpërndan modele të programeve të transparencës për kategori të ndryshme të autoriteteve publike. Në bazë të këtyre modeleve çdo autoritet publik vë në zbatim programin e tij të transparencës. Vënia në zbatim e programit të transparencës, rishikimi dhe ndjekja e procedurës për rishikimin e tij janë detyrime që i ngarkohen titullarit të autoritetit publik duke qenë se është edhe subjekti që mban përgjegjësi administrative për shkeljen e këtyre detyrimeve sipas pikës 1, të nenit 19 të ligjit. Ndërkohë në pikën 2, të po të njëjtit nen është parashikuar që titullari i autoritetit publik ka kompetencën për ushtrimin e funksioneve të parashikuara në pikën 1, të nenit 4 (vënia në zbatim e PT), pikat 1 dhe 2, të nenit 5 (rishikimi i PT) dhe këtë kompetencë ta delegojë te nëpunësi më i lartë civil i autoritetit publik.

Pra, dispozitat në fuqi e kanë të përcaktuar qartë rolin dhe kompetencat e Komisionerit dhe titullarit të institucionit. E njëjta praktikë/procedurë që është ndjekur që nga hyrja në fuqi e ligjit për të drejtën e informimit e deri më tani do të ndiqet edhe pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve që parashikon ky projektligj.

**1.8 Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme** ka përcjellë disa komente. Konkretisht sugjerohet rishikimi i pikës 2 të nenit 17 të ligjit për të drejtën e informimit dhe harmonizimin e saj me pikën 1, të nenit 3, të Konventës së Këshillit të Evropës “Për aksesin në dokumente zyrtare”, sa i përket kritereve që duhet të plotësojnë kufizimet mbi dhënien e informacionit. Në lidhje me këtë sugjerim vlerësojmë se nuk rezulton asnjë mospërputhje ose konflikt midis

dispozitive të sipërcituara, përkundrazi ligji për të drejtën e informimit, jo vetëm që është në përputhje me këtë Konventë, por garanton edhe standarde më të larta transparence se vetë Konventa.

Në përputhje me nenin 3 të Konventës, kufizimet janë të përcaktuara saktësisht në pikat 1 dhe 2 të nenit 17, të ligjit duke përcaktuar se e drejta për informim mund të kufizohet në rast se është e domosdoshme, proporcionale dhe nëse dhënia e informacionit dëmton interesat e parashikuara në pikën 1 të nenit 3 të Konventës. Gjithashtu, në përputhje me pikën 2, të nenit 3, të Konventës, në paragrafet e dyta të pikave 1 dhe 2 është parashikuar shprehimisht se informacioni i kërkuar nuk refuzohet në rast se ekziston një interes publik më i lartë për dhënicën e tij. Përputhshmëria e pikës 3, të nenit 3, të Konventës, në ligjin nr. 119/2014 është e parashikuar paragrafët e tretë, katërt dhe të pestë të pikës 2 të nenit 17.

Gjithashtu, përputhshmëria e ligjit nr. 119/2014 me Konventën është shqyrtuar edhe gjatë fazës së hartimit të projektligjit "Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës "Për aksesin në dokumente zyrtare" dhe shqyrtimit të tij nga ana e Kuvendit. Konkretisht, në relacionin shpjegues të projektligjit<sup>1</sup> është theksuar se *"Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, si autoriteti përgjegjës për zbatimin e legjislacionit në fuqi që lidhet me informimin, është shprehur në shkresën nr.1353/1 prot., datë 13.11.2020, se për sa kohë konventa vendos standarde minimale, që duhen zbatuar në shqyrtimin e kërkesave për akses në dokumente zyrtare, me aderimin në këtë konventë nuk është i nevojshëm realizimi i ndërhyrjeve në legjislacionin kombëtar. Sa i takon mundësisë së kryerjes së deklaratave të mundshme, me shkresën nr.103/2 prot., datë 31.7.2019 se, zyra e komisionerit si institucion kontribuues në këtë nismë, ka vlerësuar se me aderimin në këtë konventë, nuk lind nevoja për paraqitjen e rezervave ose deklaratave mbi aktin në fjalë."*

Gjithashtu, çështja e përputhshmërisë së ligjit nr. 119/2014 dhe Konventës është ngritur edhe gjatë shqyrtimit të projektligjit "Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës "Për aksesin në dokumente zyrtare"<sup>2</sup>, nga Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut në Kuvend. Në procesverbalin e mbledhjes së këtij komisioni<sup>2</sup>, të zhvilluar më datë 22.04.2022,

<sup>1</sup> <http://www.parlament.al:5000/Files/20220902181454789320220408125343RELACION%20-%20AKSESI%20NE%20DOKUMENTET%20ZYRTARE.pdf> fq. 4.

<sup>2</sup> <http://www.parlament.al:5000/Files/20220902180624875720220426174747Raport%20Konventa%20me%20CoE%20akses%20ne%20docs.%20zyrtare.pdf> fq. 6.

Relacion shpjegues për projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin 119/2014 "Për të drejtën e informimit"<sup>3</sup>.

rezulton se: "Me ratifikimin e kësaj konvente, me qëllim integrimin e saj në sistemin juridik të brendshëm dhe për zbatimin efektiv të parashikimeve në të, ngrihet pyetja/çështja nëse Shqipërisë i lind detyrimi për të identifikuar, përshtatur dhe harmonizuar legjislacionin vendas në fushën e të drejtës së informimit dhe aksesit në dokumente zyrtare, në përputhje me parashikimet e nenit 2, pika 2, të konventës, në bazë të së cilit përcaktohet se secila palë duhet të marrë masat e nevojshme në ligjin e vet kombëtar, për zbatimin e dispozitave për akses në dokumente zyrtare të përcaktuara në këtë konventë.

Në vlerësim të kësaj çështjeje, autoriteti përgjegjës për zbatimin e legjislacionit në fuqi që lidhet me informimin (Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale) ka konfirmuar zyrtarisht se duke konsideruar se konventa vendos standarde minimale, që duhen zbatuar në shqyrtimin e kërkesave për akses në dokumente zyrtare, me ratifikimin e kësaj konvente nuk lind nevoja për ndërhyrje në legjislacionin kombëtar.

Gjithshtu, në Konventë parashikohet shprehimisht (Seksioni 1, Neni 1) se dispozitat e saj nuk çënojnë ligje dhe rregullore kombëtare dhe traktate ndërkombëtare, të cilat njohin një të drejtë më të zgjeruar të aksesit në dokumente zyrtare. Miratimi i kësaj konvente gjen përputhshmëri dhe harmonizim me legjislacionin shqiptar dhe me standardet e Bashkimit Evropian në aktet ligjore të tilla, si: Ligji Nr. 146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik", ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e 7 informimit", ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale", të ndryshuar, etj."

Sa më sipër, si dhe në kushtet kur projektligji nuk parashikon asnjë ndryshim në rastet e kufizimit të së drejtës për informim të cilat janë garantuar tashmë nga ligji nr. 119/2014 vlerësohet se nuk rezulton që të ketë mungesë harmonizimi të dy akteve. Përkundrazi, Konventa parashikon standarde minimale, ndërkohë ligji nr. 119/2014 garanton standarde më të larta.

Konkretisht ligji nr. 119/2014 parashikon kufizim të së drejtës për informim vetëm nëse dëmtohen interesat për formulimin e politikave monetare dhe fiskale të shtetit (shkronja "d", e pikës 2, të nenit 17 të ligjit nr. 119/2014) në krahasim me kufizimin për politikën ekonomike, monetare dhe valutore të shtetit (shkronja "h" e pikës 1, të nenit 3, të Konventës.)

Gjithashtu, ligji nr. 119/2014, në shkronjën "dh", të pikës 2, të nenit 17 parashikon kufizim për mosdëmtimin e mbarëvajtjes së procesit gjyqësor, ndërsa shkronja "i", e pikës 1, të nenit 3 të Konventës parashikon kufizim për

Relacion shpjegues për projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin 119/2014 "Për të drejtën e informimit".



rastet që cenojnë administrimin e efektshëm të drejtësisë. Pra, ligji nr. 119/2014 kufizimin e së drejtës për informim e lidh vetëm me mbarëvajtjen e procesit gjyqësor, i cili është një nga disa aspektet e termit më të gjerë të administrimit të efektshëm të drejtësisë.

Standard më i lartë i ligjit nr. 119/2014 vihet re edhe në rastet e parashikuara nga shkronja "ë", e pikës 2, të nenit 17, në krahasim me rastet e parashikuara nga shkronja "k", e pikës 1, të nenit 3 të Konventës. Konkretisht, ligji nr. 119/2014 parashikon kufizim vetëm për zhvillimin e politikave publike, kurse Konventa parashikon kufizimin për shqyrtimin e një "çështjeje", e cila jo domosdoshmërisht është politikë publike, por mund të përfshijë edhe çështje të tjera që nuk futen në kategorinë e politikave publike.

Në lidhje me sugjerimin që në nenin 24/2, krahas kërkesave abuzive të shtohen edhe sanksione administrative ndaj kërkuësve, sqarojmë se neni 24/2 është hequr dhe rrjedhimisht nuk mund të vendosen as sanksioneve ndaj kërkuësve.

Sa i përket komentit mbi shtimin e rasteve të keqpërdorimit të informacionit sillel në vëmendje se sipas pikës 1 të nenit 3 të ligjit për të drejtën e informimit dhe pikës 1, të nenit 4 të Konventës së sipërcituar personi nuk ka detyrimin që të japë arsye ose të shpjegojë motivet për të cilat kërkon informacionin publik. Në këto kushte nuk mund të arrihet në konkluzionin nëse informacioni keqpërdoret ose jo për shkak se autoriteti publik, në momentin e marrjes së kërkesës për informacion dhe në momentin e dhënies së informacionit, nuk është në dijeni se si do të përdoret informacioni, rrjedhimisht edhe të faktit nëse është keqpërdorur apo jo.

**1.9 Ministria e Financave dhe Ekonomisë** është shprehur se duke qënë se në ligjin në fuqi nuk është specifikuar qartë, se cila strukturë/drejtori brenda institucioneve duhet të ngarkohet me përgjegjësi për të caktuar koordinatorin për të drejtën e informimit, në ndryshimet e këtij ligji propozojmë që në nenin 10 pika 1 të ndryshohet: autoriteti publik cakton një prej nëpunësve si koordinator për të drejtën e informimit. Pra të specifikohet roli, pozicioni i punës, si dhe kategoria e nëpunësit.

Sa i përket këtij komenti sqarojmë se sipas pikës 1 të nenit 2, termi autoritet publik, përfshin institucione të pushteteve të ndryshme, të tipologjive të ndryshme dhe që kanë një organizim dhe natyrë të ndryshme të ushtrimit të

kompetencave. Për këtë shkak, në projektligj nuk mund të përcaktohet shprehimisht dhe në mënyrë shteruese se cili do të jetë roli, pozicioni i punës dhe kategoria e nëpunësit. Një përcaktim i tillë mund të kthehet në shkak për mosaktimin e koordinatorit për shkak se autoriteti publik nuk ka një nëpunës/pozicion pune që i përgjigjet kushteve që mund të vendosë ligji. Për këtë shkak, në lidhje me këtë çështje do të vijohet të ndiqet praktika e ngritur deri më tani, sipas së cilës, çdo autoritet publik, në përputhje me organizimin e tij të brendshëm cakton një nga nëpunësit si koordinator për të drejtën e informimit.

Sa i përket sugjerimit për njohjen e punës së koordinatorit, si dhe angazhimin e tij profesional në këtë proces, duke e shtuar në përshkrimin e punës së pozicionit të tij përtej detyrave funksionale të drejtorisë që bën pjesë, sqarojmë se kompetencat dhe detyrat e koordinatorit janë të përcaktuara në ligj. Një përcaktim i tillë është i mjaftueshëm dhe çdo nëpunës që caktohet si koordinator, ka automatikisht si pjesë të punës së tij edhe këto kompetenca shtesë. Ndërkohë, shtimi ose jo i këtyre kompetencave, në përshkrimin e punës së pozicionit të nëpunësit, përtej detyrave funksionale të drejtorisë që bën pjesë, është në zgjedhjen e autoritetit publik. Kjo për shkak se siç është theksuar më sipër, këto kompetenca dhe detyra janë të parashikuara në ligj, çka mjafton për të njohur punën dhe angazhimin profesional të nëpunësit si koordinator.

Sugjerimi që pozicioni i punës së koordinatorit të jetë në shkallë hierarkie më të lartë se specialisti, duke qenë se bëhet fjalë për një rol të rëndësishëm që ngarkon me përgjegjësi gjithë institucionin, është trajtuar më poshtë, për të gjithë institucionet që kanë përcjellë komente të ngjashme.

1.10 Komentet e **DAP** për riformulimin e pikave 1 e 4, të nenit 10 janë pranuar.

2. Me anë të shkresës nr. 3678/3 prot., datë 19.10.2022, projektligji i është dërguar të gjithë institucioneve të pavarura dhe atyre të krijuara me ligj.

2.1 Nuk kanë përcjellë mendim: Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, Komisionerët Publikë, Byroja Kombëtare e Hetimit, Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, Shkolla e Magjistraturës, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, Instituti i Studimeve të Krimeve dhe të Pasojave të Komunizmit në Shqipëri, Bordi i Mbikëqyrjes Publike, Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit, Autoriteti i Konkurrencës, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të

Relacion shpjegues për projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin 119/2014 "Për të drejtën e informimit".

Shtetit, Enti Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura, Enti Rregullator i Energjisë, Dhoma e Avokatisë së Shqipërisë, Dhoma Kombëtare e Noterisë, Dhoma Kombëtare e Përmbaresve Gjyqësorë Privatë, Urdhri i Mjekëve, Urdhri i Infermierëve, si dhe Urdhri i Psikologut.

Në kushtet kur këto institucione nuk kanë përcjellë komente brenda afatit 7 ditor të parashikuar nga pika 28, e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 584/2003, "Për miratimin e rregullores së Këshillit të Ministrave", i ndryshuar, konsiderohet se janë dakord dhe nuk kanë vërejtje për projektaktin.

2.2 kanë përcjellë dakordësinë: Autoriteti i Mediave Audiovizive, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, Kontrolli i Lartë i Shtetit, Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, INSTAT, Komisioni i Prokurimit Publik, dhe Prokuroria e Përgjithshme.

2.3 Kanë përcjellë komente: Inspektori i Lartë i Drejtësisë, Agjencia e Sigurimit të Depozitave, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Kolegji i Posaçëm i Apelit, Banka e Shqipërisë, Këshilli i Lartë Gjyqësor, si dhe Avokati i Popullit.

2.4 Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe Kolegji i Posaçëm i Apelit kanë përcjellë komente në lidhje me shtimin e nenit 24/2 mbi kërkesat abuzive duke u shprehur se nevojiten të përcaktohen kritere për të klasifikuar një kërkesë si abuzive. Pas vlerësimit në tërësi të të gjitha komenteve, neni 24/2 është hequr nga përmbajtja e projektligjit.

Në lidhje me kompetencat e Komisionerit sipas shkronjave "ç" dhe "d" të pikës 2, të nenit 9/1, kanë përcjellë komente disa institucione të renditura si më poshtë.

2.5 Kolegji i Posaçëm i Apelit është shprehur se duhet vlerësuar nëse e drejta që Komisioneri të propozojë deklasifikimin e një informacioni publik tejkalon kompetencat dhe shkallën e ekspertizës që ka institucioni. Në lidhje me këtë koment sqarojmë se Komisioneri në ushtrim të kompetencave të tij për garantimin së drejtës për informim dhe nxitjes së transparencës së autoriteteve publike, ka të drejtën vetëm për t'i kërkuar autoritetit klasifikuar deklasifikimin e informacionin. Ky propozim është në përputhje me kompetencat e mësipërme, por gjithsesi do të mbetet në vlerësimin e institucionit përkatës nëse do të deklasifikojë ose jo informacionin. Në këtë mënyrë, Komisioneri nuk i tejkalon

kompetencat e tij dhe për arsye se nuk ka të gjithë ekspertizën e nevojshme në këtë fushë, mundet vetëm t'i kërkojë dhe jo të urdhërojë autoritetin e klasifikimit për deklasifikimin e informacionit.

**2.6 Këshilli i Lartë i Prokurorisë** ka propozuar që pas fjalëve "sekret shtetëror" në shkronjën "ç", të shtohen edhe fjalët "nëse plotëson kriteret e vendosura në nenin 21, të ligjit për informacionin e klasifikuar". Në lidhje me këtë propozim sqarojmë se njohja dhe aksesimi në informacionin dhe dokumentet e klasifikuara do të kryhet në çdo rast në përputhje me parashikimet e legjislacionit për informacionin e klasifikuar. Në kushtet kur Kuvendi ka miratuar ligjin nr. 10/2023 "Për informacionin e klasifikuar", i cili është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 27, më datë 22.02.2023, vlerësohet e papërshtatshme dhe jo efektive që në ligj të kryhet referenca e jashtme duke përcaktuar nenin konkret.

Sa i përket propozimit që në shkronjën "d", fjala "*propozojë*" të zëvendësohet me fjalët "*të kërkojë pranë autoritetit të klasifikimit origjinal deklasifikimin*", komenti është pranuar dhe sugjerimi është reflektuar në projektligj.

Në lidhje me këtë çështje ka përcjellë koment edhe Banka e Shqipërisë, për të cilin vlejné të njëjtat argumente si më lart.

**2.7 Banka e Shqipërisë** gjykon se nuk është e nevojshme që të rritet frekuenca e përditësimit të Regjistrit të Kërkesave dhe Përgjigjeve, duke qenë se ky vëllim pune nuk mbulohet nga një person i dedikuar vetëm për këtë detyrë. Në lidhje me këtë koment sqarojmë se publikimi i Regjistrit të Kërkesave dhe Përgjigjeve ka një rëndësi thelbësore për njohjen e publikur me informacionin e dhënë më parë dhe nëse ai nuk publikohet në intervale më të shkurtra do të humbasë qëllimin e publikimit të tij (argumentet më të shtjelluara në lidhje me këtë ndryshim gjenden më sipër). Në këto kushte, nevoja për publikimin më të shpeshtë të tij dhe plotësimin e kërkesave të publikut për informacion prevalon mbi ngarkesën që mund t'i shtohet nëpunësit përmes këtij ndryshimi.

Sa i përket ngarkesës së nëpunësit, sqarojmë se është detyra e autoritetit publik që të caktojë si koordinator nëpunësin i cili mund të kryejë në mënyrë efektive detyrat dhe kompetencat e parashikuara nga ligji, duke marrë parasysh të gjithë faktorët, përfshirë edhe ngarkesën e punës.



Sa i përket komentit në lidhje me shtesën mbi pagë për koordinatorët dhe shkeljen e pavarësisë së institucioneve të pavarura në lidhje me çështjen e pagës, sqarojmë se komenti është pranuar dhe në mënyrë që shtesa për koordinatorët e autoriteteve publike, struktura dhe niveli i pagave të nëpunësve të cilëve nuk përcaktohet nga Këshilli i Ministrave, të përcaktohet nga organi që sipas legjislacionit në fuqi, përcakton strukturën dhe nivelin e pagave për nëpunësit e atyre autoriteteve.

Në lidhje me komentin për parashikimin e sanksionit administrativ për moszbatimin e vendimit të Komisionerit kur ka urdhëruar dhënien e informacionit të kërkuar, në mënyrë të plotë ose të pjesshme, sqarojmë se dispozita synon dënimin e rasteve të moszbatimit të ligjit dhe është në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 10 279, datë 20.05.2010 "Për kundravajtjet administrative". Konkretisht, pika 6/1 që synohet të shtohet në nenin 24, parashikon detyrimin ligjor që ka autoriteti publik për të zbatuar vendimin e Komisionerit. Pikërisht për këtë arsye, në shkronjën "o" të nenit 18, është kryer referenca në pikën 6/1 të ligjit. Pra, në këtë rast, dënohet pasiviteti ose mosveprimi i autoritetit publik për të përmbushur detyrimin për zbatimin e vendimit të Komisionerit, si dhe çdo veprim tjetër që përbën shkak për moszbatimin e vendimit.

Në lidhje vendosjen e gjobave, Banka e Shqipërisë është shprehur se autoritetet publike në varësi të trajtimit të çështjeve përcaktojnë përgjegjësitë përkatëse rast pas rasti dhe propozon që gjobat të mos i caktohen nominalisht subjekteve të përcaktuar sipas nenit 18.

Ky sugjerim nuk është pranuar. Përgjegjësia në rastet e parashikuara nga neni 18 lind për shkak të veprimeve ose mosveprimeve të individëve, qofshin këta titullarë të institucionit, nëpunës përgjegjës ose koordinatorë. Interesi publik kërkon që përmes sanksionit administrativ nga njëra anë, të parandalohen rastet e moszbatimit të ligjit dhe, nga ana tjetër, të ndëshkohet personi përgjegjës për moszbatimin e ligjit.

Nëse gjoba nuk aplikohet drejtpërdrejtë ndaj personit përgjegjës, sanksioni administrativ do të humbasë efektin, pasi nuk ka asnjë garanci se autoriteti publik do të evidentojë përgjegjësin përkatës dhe as se do ta ngarkojë atë me detyrimin për pagimin e gjobës. Sugjerimi përbën shkak që të cenohen standardet e arritura deri më tani në lidhje me respektimin e së drejtës për informim. Nëse gjoba nuk vendoset drejtpërdrejtë ndaj personit përgjegjës ka



rrezik që ai të mos respektojë ligjin dhe kështu ndaj tij të mos merret asnjë masë me karakter parandalues dhe ndëshkues. Gjendur në këto kushte, nëpunësi i autoritetit publik, me veprimin ose mosveprimin e tij, do të bëhet shkak për lindjen e përgjegjësisë administrative dhe një përgjegjësi të tillë nuk ka pse ta mbajë i gjithë autoriteti publik dhe kjo përgjegjësi të shlyhet përmes buxhetit të autoritetit publik.

Sugjerimi për heqjen e raportimit të parashikuar në nenin 24/1 nuk është pranuar pasi autoritetet publike raportojnë në mënyrë të vazhdueshme dhe periodike për veprimtarinë e tyre në zbatim të ligjit. Zbatimi i ligjit për të drejtën e informimit nuk ka pse të përjashtohet nga ky detyrim, ndërsa për ngarkesën punës së koordinitorit vlen i njëjti argument i dhënë për komentimin mbi përditësimin e Regjistrimit të Kërkesave dhe Përgjigjeve.

Sipas pikës 7 të komenteve të Bankës së Shqipërisë, ndryshimet në projektligj prishin balancën midis të drejtës së informimit dhe të drejtës së të dhënave personale duke favorizuar në mënyrë të njëanshme të parën, si dhe duke shkelur pavarësinë e institucioneve të pavarura.

Sillet në vëmendje se ky koment nuk është shoqëruar me argumente konkrete se cilat janë ato dispozita që prishin balancën midis dy të drejtave dhe se si shkelin pavarësinë e institucioneve të pavarura. Në lidhje me balancën midis dy të drejtave nuk gjendet asnjë argument mbi të cilin të bazohet ky koment, ndërsa në lidhje me pavarësinë e institucioneve të pavarura, në shkresën për mendim janë dhënë komente vetëm mbi caktimin e shtesës së pagës së koordinitorit nga Këshilli i Ministrave (të adresuar si më sipër), ndërkohë argumente të tjera në lidhje me këtë çështje nuk ka.

**2.8 Agjencia e Sigurimit të Depozitave** ka sugjeruar që të detajohen procedurat për ushtrimin e kompetencave të Komisionerit për vendosjen e sanksioneve administrative dhe propozimin e marrjes së masave disiplinore ndaj nëpunësit përgjegjës, duke parashikuar një dispozitë të veçantë për të drejtat e palëve gjatë këtyre procedurave administrative, si dhe përfshirjen e procedurës për ndërmjetësim. Në lidhje me këto sugjerime sqarojmë se Komisioneri i ushtron kompetencat e mësipërme pas kryerjes së procedurës administrative në përputhje me Kodin e Procedurës Administrative. Pavarësisht parashikimit ose jo shprehimisht në këtë ligj, ai është i detyruar që hetimin dhe të gjithë procedurën administrative ta kryejë duke zbatuar KPA i cili përmban të gjitha garancitë e nevojshme si për zhvillimin e procedurës, ashtu edhe për të drejtave e palëve.

ASD ka sugjeruar që në ligj të përcaktohen edhe kriteret që duhet të përmbushë koordinatori, të tilla si pozicioni i punës në hierarkinë e strukturës së institucionit, vjetërsia në punë e punonjësit dhe arsimi i tij. Argumentet në lidhje me këtë propozim do të jepen më poshtë, ku trajtohen bashkërisht të gjithë komentet e institucioneve dhe grupeve të interesit mbi këtë çështje.

Një tjetër sugjerim i ASD lidhet me përcaktimin shprehimisht në projektligj të kriterëve për vendosjen e sanksioneve administrative, si dhe propozimin e masave administrative nga Komisioneri. Në lidhje me këtë sugjerim sjellim në vëmendje se shkeljet e parashikuara nga neni 18, përbëjnë kundravajtje administrative dhe si pasojë, krahas dispozitave të ligjit për të drejtën e informimit zbatohen edhe dispozitat e ligjit nr. 10 279, datë 20.05.2010 "Për kundravajtjet administrative".

Në lidhje me masën e gjobës, pika 2 e nenit 10 të këtij ligji parashikon se: *"2. Në rastet kur ligji i posaçëm vendos kufij minimalë dhe maksimalë për vlerën e dënimit me gjobë, atëherë, për qëllim të marrjes së vendimit për kundërvajtjen administrative, organi administrativ kompetent për shqyrtimin e kundërvajtjes, përveç parimeve të parashikuara nga neni 18 i këtij ligji, miraton edhe metodikën apo parime të tjera shtesë, mbi të cilat mbështetet për përcaktimin e vlerës së gjobës, për rastet e kundërvajtjeve, për të cilat parashikohet i njëjti dënim."*

Ndërsa në nenin 18, parashikohen edhe kriteret për caktimin e llojit dhe masës së dënimit, ku konkretisht parashikohet se: *"Në përzgjedhjen e llojit të dënimit dhe në caktimin e masës së tij, në rastet kur ligji ka parashikuar kufij minimalë e maksimalë të vlerës së gjobës, organi që shqyrton kundërvajtjen administrative duhet të marrë parasysh:*

- a) rrethanat e kryerjes së kundërvajtjes;*
- b) nëse kundërvajtësi rezulton i dënuar administrativisht edhe më parë;*
- c) rëndësinë e kundërvajtjes;*
- ç) pasojat që kanë ardhur nga veprimi apo mosveprimi."*

Sa më sipër, rezulton i panevojshëm parashikimi në ligjin për të drejtën e informimit, i këtyre kriterëve duke qenë se ligji i sipërcituar përbën një ligj kuadër i cili zbatohet edhe për këto kundravajtje administrative.



Në lidhje me raportimin vjetor që autoritetet publike duhet të kryejnë pranë Komisionerit sipas nenit 24/1, ASD sugjeron që afati të shtyhet deri më datë 15 të muajit shkurt. Ky koment është pranuar.

## 2.9 Këshilli i Lartë Gjyqësor

KLGG ka sugjeruar që të unifikohet terminologjia në përmbajtjen e të gjithë ligjit sa i përket referencave të jashtme duke sugjeruar që të përdoret termi “legjislacioni në fuqi për...” në vend të referimit të saktë ligjeve përkatëse për shkak të ndryshimit të vazhdueshëm të tyre. Në lidhje me këtë koment, në projektligj janë bërë ndryshimet e nevojshme në përputhje me pikën 3, të nenit 32, të udhëzimit nr. 6, datë 29.4.2022 “Për përcaktimin e metodologjisë së unifikuar për hartimin e akteve normative”, duke i unifikuar terminologjinë dhe referuar saktë ligjet përkatëse.

Gjithashtu, është sugjeruar që në relacionin shpjegues të shënohet edhe fakti që janë shtuar edhe dy kompetencat e reja të Komisionerit që janë shtuar me shkronjat “gj” dhe “h”. Ky sugjerim është reflektuar.

Sa i përket sugjerimit që termi “Komisioneri” të parashikohet në përkufizimet e nenit 2 të ligjit aktual për të drejtën e informimit sqarojmë se pika 1 e nenit 9/1, nuk ka si qëllim përkufizimin e termit, pasi ai është dhënë por parashikon shprehimisht kompetencat e tij në lidhje me shqyrtimin e ankesave, monitorimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit.

Në lidhje me argumentimin për uljen e masës së gjobave të parashikuara në projektligj, KLGJ ka kërkuar të përcaktohen nëse në argument referohet paga neto apo bruto. Në vijim të kësaj kërkesë sqarojmë se referenca e pagave bazohet në vendimin nr. 165, datë 2.3.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”, të ndryshuar.

Në lidhje me ndryshimet në pikën 2, të nenit 19 KLGJ shprehet se: *“Nga mënyra e formulimit të kësaj dispozite nënkuptohet se nenet e sipërcituara i referohen Kodit të Procedurave Administrative, megjithatë rezolton se në fakt ky referim është i gabuar pasi këto nene i përkasin ligjit për nëpunësin civil (ashtu siç është parashikuar në ligjin aktual për të drejtën e informimit). Për*

*këtë arsye sugjerojmë që të bëhen verifikimet dhe të vendoset referenca e duhur ligjore.”.*

Në lidhje me këtë sugjerim sqarojmë se, si në ligjin në fuqi, ashtu edhe në projektligj, nenet referojnë në ligjin për të drejtën e informimit dhe jo në KPA ose ligjin për nëpunësin civil. Megjithatë, nisur nga ky koment, pas togfjalëshit “të nenit 13” janë shtuar fjalët “të këtij ligji”, me qëllim shmangien e paqartësive.

Gjithashtu, KLGJ ka sugjeruar rishikimin ndryshimeve në lidhjen me ndarjen e përgjegjësiave pasi një pjesë e kompetencave të koordinatorit i janë atribuuar personave të tjerë përgjegjës, si dhe shtimin e shkronjës “nj”, në pikën 3. Në lidhje me këtë sugjerim sqarojmë se termi person përgjegjës, përfshin të gjithë ato subjekte që shkelin dispozitat e këtij ligji dhe përfshin titullarin e autoritetit publik, koordinatorin dhe nëpunësin përgjegjës. Në këto kushte, koordinatori mban përgjegjësi për shklejet e parashikuara në shkronjat “d” dhe “e”, të pikës 2, të nenit 18, pasi lidhen me kompetenca specifike të tij, ndërsa për çdo shkelje tjetër, të parashikuar në shkronjat “a”, “dh”, “ë”, “f”, “g”, “i”, “j”, “k”, “l”, “ll” dhe “nj” të pikës 2, të nenit 18, koordinatori do të mbajë përgjegjësi si person përgjegjës. Argumentimi i plotë në lidhje me këtë çështje gjendet në pikën 3, të seksionit të tretë, të këtij relacioni.

**2.10 Avokati i Popullit** sugjeron që ligji të përmbajë përcaktime të qarta në drejtim të kuptimit “sekret tregtar” ose referencë të qartë në legjislacionin ligjin nr. 9947, datë 7.7.2022 “Për pronësinë industriale”.

Ky koment është pranuar dhe në nenin 2, janë kryer shtesat e nevojshme me qëllim që termat “e drejta e autorit”, “patentë” dhe “sekret tregtar” të kenë të njëjtin kuptim me atë të parashikuar në ligjet përkatëse.

Gjithashtu, Avokati i Popullit ka sugjeruar rregullimin e terminologjisë në pikën 5, të nenit 17, në mënyrë që termi “refuzohet” të zëvendësohet me fjalën “kufizohet”. Ky sugjerim është pranuar.

Avokati i Popullit sugjeron që të rishikohet pika 4 e nenit 14, e cila parashikon detyrimin e autoritetit publik për të disponuar me vendim të shkruar dhe të arsyetuar në rastet e refuzimit për formën e kërkuar të informacionit.

Në lidhje me këtë sugjerim sqarojmë se pika 4 parashikon detyrimin e autoritetit publik për të njoftuar me shkrim dhe në mënyrë të arsyetuar vendimin për refuzimin për dhënie të informacionit në formën e kërkuar në mënyrë të tillë që

Relacion shpjegues për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin 119/2014 “Për të drejtën e informimit””.

personi të njihet me arsyet e refuzimit dhe nëse e vlerëson të nevojshme të ushtrojë mjetet ligjore administrative. Sillet në vëmendje se arsyetimi është një ka elementët kryesorë të përmbajtjes së aktit administrativ.

2.11 Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore ka përcjellë vendimin nr. 7 datë 12.12.2022, të Këshillit Konsultativ Qeverisje Qendrore – Qeverisje Vendore ku janë dhënë komentet e këtij këshilli mbi projektaktin.

Këshilli paraqet nevojën për saktësim lidhur me ndryshimet në masat e gjobave në referencë të parimit të proporcionalitetit, nisur nga fakti se jo në të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore, niveli i pagave të nëpunësve publikë është i njëjtëm, si dhe nga fakti se jo për të gjitha shkeljet e parashikuara nga ligji, kufiri minimal i gjobës është ulur. Në lidhje me këtë sugjerim sillet në vëmendje se siç është shpjeguar edhe më lart në këtë relacion, në analizë është marrë niveli më i ulët i pagave të nëpunësve publikë të njësisve të vetëqeverisjes vendore.

Sa i përket komentit mbi publikimin e programit të transparencës në faqen zyrtare të autoritetit publik, theksojmë se dispozitat ka si qëllim parashikimin e detyrimit të organeve publike në faqen e internetit të programit të transparencës nga ana e të gjithë autoriteteve publike.

Këshilli ka sugjeruar heqjen e fjalës “veçanërisht” në shkronjën “e” të pikës 2, të nenit 5. Sa i përket fjalës “veçanërisht”, sqarojmë se rregulli i përgjithshëm është që Komisioneri të kryejë një gamë të gjerë aktiviteteve për nxitjen e autoriteteve publike, zgjedhja e të cilat mbeten në vlerësimin e tij. Përmes fjalës “veçanërisht”, krahas gamës së gjerë të aktiviteteve për nxitjen e transparencës së autoriteteve publike, vihet theksi në aktivitete dhe tematika për çështje të së drejtës së informimit në mënyrë që pavarësisht zgjedhjes për kryerjen e aktiviteteve me tematika të tjera, Komisioneri të ketë detyrimin që të organizojë domosdoshmërisht aktivitete për sensibilizimin dhe informimin mbi çështje të së drejtës së informimit.

Në lidhje me heqjen e fjalëve “si dhe organizon trajnime për këtë qëllim”, në shkronjën “e” të pikës 2, të nenit 5, me arsyetimin se kjo kompetencë përfshihen në parashikimin e shkronjës “gj”, sqarojmë se komenti është pranuar.

Në lidhje me komentin për të specifikuar vetëm një subjekt që mban përgjegjësi për shkeljen e parashikuar në shkronjën “nj”, të pikës 2, të nenit 18 (titullari i autoritetit ose nëpunësi përgjegjës), theksohet se shkelja mund të kryhet



njëkohësisht nga të dy këto subjekte, në bashkëpunim ose për shkak të mos ushtrimit të detyrave të secilit prej subjekteve. Gjithashtu, nëse përcaktohet se përgjegjësinë e mban vetëm personi përgjegjës, ekziston mundësia që personi përgjegjës të kryejë shkeljen si pasojë e zbatimit të urdhrave të titullarit të autoritetit. Në këtë rast titullari nuk mban përgjegjësi pasi ligji mund të keqinterpretohet për të shmangur përgjegjësinë e titullarit duke arsyetuar se titullari mban përgjegjësi vetëm për shkeljet e parashikuar në pikën 1. Nga ana tjetër, nëse parashikohet se përgjegjësinë e mban vetëm titullari i institucionit dhe jo personi përgjegjës, ligji mund të keqinterpretohet me të njëjtin arsyetim si më sipër.

Sa i përket komentit për kërkesat abuzive, sqarojmë se dispozita është hequr. Pjesa tjetër e komenteve janë të njëjtja me komentet të cilat janë përcjellë nga shoqëria civile dhe që janë trajtuar më poshtë.

3. Pas përfundimit të draftit, projektligji është publikuar në RENJK më datë 19.10.2022 dhe afati i konsultimit prej 20 ditësh punë ka mbaruar më datë 15.11.2022.

3.1 Shoqëria civile ka përcjellë komente mbi nenin 24/2 i cili parashikon mënyrën e trajtimit të kërkesave abuzive, të cilat janë pranuar dhe ky nen është hequr nga përmbajtja e ligjit.

3.2 Një nga sugjerimet dhe komentet e shoqërisë civile, si dhe të institucioneve të sipërcituara është edhe që koordinatori të caktohet nga radhët e nëpunësve të rangut të lartë të autoritetit publik. Ky sugjerim lidhet me detyrën e tij për të bashkërenduar punën me strukturat e tjera që nuk i ka në varësi dhe rrjedhimisht përballet me neglizhencë apo refuzim të këtyre strukturave për t'i përcjellë informacionin e plotë dhe të saktë. Ndaj një nga kriteret e rëndësishme për t'u përfshirë në projektligj është pozicioni i lartë që duhet të mbajë koordinatori në hierarkinë e institucionit dhe detyrimi për titullarin e institucionit që të urdhërojë strukturat e tjera për të mbështetur dhe bashkëpunuar me koordinatorin për të drejtën e informimit gjatë përmbushjes së detyrës së tij.

Në lidhje me propozimin e mësipërm theksojmë se një problematikë e tillë është edhe shkak i rikonceptimit të përgjegjësisë së koordinatorit dhe nëpunësit përgjegjës. Neglizhenca apo mosbashkërendimi i punës me strukturat e tjera që nuk i ka në varësi nuk kanë ardhur domosdoshmërisht për shkak të pozicionit të punës që mban koordinatori. Këto fenomene kanë si burim kryesor faktin se i vetmi subjekt që sipas dispozitave aktuale ngarkohet me përgjegjësinë

administrative është koordinatori, ndërsa nëpunësi përgjegjës nuk ka ndjerë përgjegjësinë e duhur për zbatimin e ligjit. Duke qenë se tashmë përgjegjësinë për moszbatimin e ligjit, do ta ketë çdo nëpunës përgjegjës, i cili me veprimet ose mosveprimet e tij ka sjellë si pasojë shkeljen e ligjit, kjo neglizhencë dhe mungesë bashkëpunimi me koordinatorin nuk do të jetë më evidente.

Kjo për shkak se përgjegjshmëria e nëpunësve të autoritetit publik, qofshin këta të nivelit të ulët apo të lartë, do të rritet për shkak se do të gjenden përballë pasojave që sjell mosbashkëpunimi me koordinatorin, neglizhencia në trajtimin e kërkesave për informacion ose edhe vetë mosdhënia e informacionit në kundërshtim me parashikimet e ligjit. Rreziku që ndaj nëpunësit përgjegjës të vendoset sanksioni administrativ ose që Komisioneri të propozojë marrjen e masave disiplinore ndaj tij, jo vetëm që do të rrisë bashkëpunimin me koordinatorin, por do të ndikojë në mënyrë të drejtpërdrejtë që ai të tregojë kujdesin e duhur në lidhje me trajtimin e kërkesës për informacion në përputhje me ligjin.

Edhe caktimi i koordinatorit nga radhët e nëpunësve të rangut të lartë të autoritetit publik, nuk sjell ndonjë dobi të veçantë në drejtim të bashkërendimit të punës dhe shmangies së neglizhencës, pasi në çdo rast edhe nëpunësi i rangut të lartë do të ketë sektorë apo drejtori të cilat nuk do të jenë në varësinë e tij.

Situata të tilla do të shmangeshin vetëm nëse koordinatori do të caktohet titullari i institucionit ose sekretari i përgjithshëm i tij. Kjo hipotezë është qartësisht e papërshtatshme për shkak se ngarkesa e punës së këtyre subjekteve nuk do të lejonte kryerjen me efektivitet të detyrave të koordinatorit.

Nga ana tjetër, detyrimi për bashkëpunim me koordinatorin është një detyrim i cili lind për shkak të vetë kompetencave që ligji për të drejtën e informimit i ka dhënë atij. Siç është theksuar edhe më lart, nëse koordinatori i kryen detyrat që ligji i ka ngarkuar atij, por informacioni nuk i është vendosur në dispozicion publikut për shkak të mungesës së bashkëpunimit të nëpunësit përgjegjës me koordinatorin, nëpunësi përgjegjës do të përballë me përgjegjësinë administrative që lind në këtë rast për shkak të mosveprimit.

Bashkëpunimi i nëpunësve me koordinatorin është pjesë e detyrimit për bashkëpunimin e nëpunësve me të gjithë strukturat e tjera të brendshme të autoritetit publik. Një detyrim i tillë parashikohet edhe në pikën 7, të nenit 3, të ligjit nr. 90/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore" ku i është kushtuar vëmendje e veçantë parimit të bashkëpunimit. Sipas këtij

Relacion shpjegues për projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin 119/2014 "Për të drejtën e informimit".



parimi, organet, institucionet dhe njësitë administrative, si dhe nëpunësit publikë, në të gjitha nivelet e administratës, bashkëpunojnë ndërmjet tyre, si dhe me organet e institucionet e pavarura, për arritjen e objektivave ligjore që u janë besuar, në përputhje me ligjin. Në këto kushte, vlerësohet e panevojshme përsëritja e këtij parimi edhe në ligjin për të drejtën e informimit.

Ndërkohë, çështja e bashkëpunimit, krahas rregullimit ligjor është edhe një çështje e cila mund të parashikohet në rregulloren e brendshme të autoritetit publik. Në këtë mënyrë është vepruar nga ana e Ministrisë së Drejtësisë. Krahas rregullave të tjera, Rregullorja e Brendshme e Ministrisë së Drejtësisë<sup>3</sup> ka parashikuar edhe rregullat për bashkëpunimin e koordinatorit dhe nëpunësve të strukturave përkatëse në nenin 71 të saj, ku janë përcaktuar aspektet kryesore të këtij bashkëpunimi. Pra në thelb, kjo është një çështje që mund të rregullohet nga zbatimi në praktikë i ligjit.

Në lidhje me çështjen e caktimit të koordinatorit për të drejtën e informimit nga radhët e nëpunësve të rangut të lartë, duhet mbajtur në konsideratë edhe fakti se ka disa autoritete publike që për shkak të organizimit dhe strukturës të tyre ose për shkak të natyrës së tyre nuk kanë një pozicion të tillë ose i vetmi pozicion i këtij rangu është ai i titullarit të institucionit. I tillë është rasti i Arkivit Shtetëror të Sistemit Gjyqësor i cili organizohet si drejtori që ka në krye drejtorin e arkivit dhe specialistët e sektorëve përkatës dhe struktura e tij nuk parashikon një pozicion pune në nivelin e përgjegjësit të sektorit.

Sa i përket propozimeve që ligji të parashikojë edhe kritere të tjera për caktimin e koordinatorit për të drejtën e informimit, të tilla si arsimimi dhe vitet e eksperiencës së punës në autoritetin publik sillen në vëmendje se një përcaktim i tillë mund të sjellë pasoja negative dhe moscaktim të koordinatorit. Kjo për shkak se ka institucione të cilat për shkak të natyrës së tyre nuk kanë në përbërje të tyre nëpunës që mund të plotësojnë njëkohësisht të gjitha kriteret siç do të ishte eksperiencia profesionale në atë institucion dhe kriterin e arsimit.

Edhe për këto kritere vlen të merret në analizë një institucion si Arkivi Shtetëror i Sistemit Gjyqësor, në strukturën e të cilit nuk evidentohen nëpunës të cilët të kenë si kriter për punësimin arsimin e lartë në drejtësi, ndërsa fushat e tjera të studimit mund të konsiderohen të papërshtatshme për kryerjen e detyrave të koordinatorit. Problematika thellohet ende më shumë në rastet kur edhe pse

<sup>3</sup> <https://drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2022/04/Rregullorja-e-MID-s%C3%AB.pdf>

nëpunësi mund të ketë ndjekur studimet e larta në fushën e drejtësisë, ai përsëri nuk do të plotësonte kriterin e përvojës minimale të punës në autoritetin publik.

Mospërbushja e qoftë edhe të vetëm njërit prej këtyre kriterëve do të sillte si pasojë që autoriteti publik të mos caktonte koordinatorin për të drejtën e informimit duke cenuar kështu në mënyrë të drejtpërdrejtë të drejtën për informim, si dhe duke sjellë një situatë kur zbatimi i ligjit është i pamundur për shkaqe objektive.

Në këto kushte, është më e përshtatshme që ligji ta lërë në diskrecionin e autoritetit publik caktimin e koordinatorit nga radhët e nëpunësve të tij dhe në rast se nëpunësi i caktuar nuk tregon një performancë të përshtatshme në ushtrimin e detyrave, autoriteti publik mund ta ndryshojë atë në çdo kohë. Rol të veçantë në këtë vlerësim luan edhe Komisioneri i cili me raportet e tij periodike vlerëson performancën tërësore të autoritetit publik në respektimin e ligjit, përfshirë këtu në mënyrë indirekte edhe performancën e koordinatorit për të drejtën e informimit.

3.3 Në lidhje me pikën 5, të nenit 15 dhe pikën 7, të nenit 17 janë përcjellë komente nga ana e shoqërisë civile. Sipas tyre, këto dispozita kufizojnë aksesin në informacion. Ligji aktual për arkivat nuk siguron parimisht ndonjë të drejtë të shprehur të aksesit të publikut në arkiva dhe kështu mbetet që këtë të drejtë parimisht ta shprehë ligji nr. 119/ 2014. Nëse ky ligj lejon akses vetëm në informacionin e përkohshëm, ndryshe nga parashikimet aktuale që sigurojnë akses në informacione të cdo lloji, përbën regres të drejtash. As Komisioneri, por as praktika nuk ka evidentuar problematika që mund të justifikonin dhe të sillnin nevojën për një ndryshim të tillë. Nëse problemi që ka shtyrë këtë ndryshim lidhet me kostot e dhënies së informacionit, ky aspekt mund të rregullohet me tarifa të veçanta, siç rregullohet aktualisht nga ligji.

Në lidhje me këtë koment sqarojmë se, argumentet në lidhje me problematikën dhe nevojën për ndryshimet e sipërcituara janë dhënë në pikën 9 të seksionit të tretë të këtij relacioni. Sa i përket komentit sjellim në vëmendje se ndryshimet janë bërë në nenin 11 dhe nenin 15 të ligjit. Konkretisht, me shtimin e pikës 6, në nenin 11 parashikohet që kërkesat për njohjen me informacionin arkivor të ruajtur në arkivat e përhershëm, trajtohen në përputhje me parashikimet e legjislacionin në fuqi për arkivat, duke ushtruar të drejtën e shfrytëzimit të dokumentacionit. Kjo për shkak se është e pamundur që autoriteti publik të përmbushë në kohë kërkesat e të gjithë personave në lidhje me dokumentacionin

që gjendet në arkivat e përhershëm. Për këtë arsye, personit i njihet e drejta që jo vetëm të kërkojë informacionin publik të ruajtur në këto arkiva, por të ketë vetë qasje të drejtpërdrejtë, në kërkimin e tij dhe në njohjen me informacionin.

Ndërkohë, ndryshimi në pikën 5, të nenit 15 është kryer me qëllim harmonizimin e dispozitës me pikën 6, të nenit 11. Në këtë mënyrë, për informacionin që gjendet në arkivat në veprim, autoriteti publik është i detyruar t'i kthejë përgjigje kërkuarit brenda afatit të parashikuar nga neni 15, ndërsa për informacionin e ruajtur në arkivat e përhershëm, nuk ka një afat të përcaktuar pasi qasja në informacionin publik të ruajtur në arkivat e përhershëm do të kryhet në çdo kohë dhe drejtpërdrejtë nga personi. Megjithatë, nëse personi i drejtohet arkivit të përhershëm për marrjen e informacionit publik të ruajtur nga ai, autoriteti publik është i detyruar që brenda 10 ditëve pune të njoftojë kërkuarin mbi të drejtën e tij për shfrytëzimin e dokumentacionit.

3.4 Një nga rekomandimet e shoqërisë civile është që në nenin 6 të ligjit pas togfjalëshit *"miraton dhe shpërndan modele të programeve të transparencës"*, të shtohet togfjalëshi *"të përshtatura/ individualizuara për çdo..."* Ky propozim argumentohet me faktin se organet publike kanë veprimtari të ndryshme, prodhojnë dhe mbajnë dokumenta, akte të ndryshme edhe modelet e transparencës duhet të përshtaten me veprimtarinë dhe organikën e institucionit. Gjatë monitorimeve të kryera për transparencën proaktive të autoriteteve publike është vënë re shpesh që të njëjtat rregulla nuk zbatohen njëjloj për secilin autoritet publik.

Në lidhje me këtë propozim theksojmë se ligji tashmë e ka të parashikuar detyrimin që Komisioneri të miratojë modele të programeve të transparencës të përshtatura / individualizuara për çdo autoritet publik në shkronjën "c", të pikës 2, të nenit 4 (modelet e miratuara për kategorinë e autoritetit publik nga Komisioneri), në nenin 6 (modele të programeve të transparencës për kategori të ndryshme të autoriteteve publike), në pikën 1, të nenit 7 (Në përputhje me programin e transparencës së miratuar për çdo autoritet publik). Në interpretim të të gjitha këtyre dispozitave, Komisioneri ka detyrimin që të miratojë programe të transparencës të ndryshme për kategori të ndryshme të autoriteteve publike, si dhe në rast se një autoritet publik nuk mund të përfshihet në ndonjë nga kategoritë, të miratojë një program të veçantë transparence për të.



Sa më sipër, vlerësohet i panevojshëm shtimi i një dispozite tjetër e cila në thelb parashikon të njëjtin detyrim për Komisionerin. Në këto kushte, adresimi i këtij komenti nuk lidhet me mangësitë apo vakumin ligjor, por me çështjen e zbatimit të këtyre dispozitave nga ana e Komisionerit.

3.5 Shoqëria civile është shprehur se paraqet rëndësi të veçantë që procedura e marrjes së vendimit për konstatimin e kundërvajtjes administrative duhet të jetë e veçuar nga ajo e dhënies së informacionit. Në praktikë, Komisioneri, kur trajton një ankesë për refuzim informacioni, heton edhe për shkaktarët e pengesës së dhënies së informacionit, duke bërë inspektime në terren. Nëse Komisioneri do e shqyrtonte më vete ankesën për refuzim të dhënies së informacionit, do merrte një vendim më të shpejtë. Pjesa tjetër, që lidhet me shkeljet administrative dhe konkretisht me shkaktarët e pengesë së aksesit në informacion mund të marrë kohën e vet, duke bërë të gjithë inspektimet e nevojshme, ndërkohë që ankesa e qytetarit është adresuar më herët.

Duke u bashkuar me konstatimin se procedura për shqyrtimin e kundërvajtjes administrative duhet të zhvillohet e ndarë nga procedura për shqyrtimin e ankimit për mosdhënie të informacionit, theksojmë se kjo është një çështje e kuptimit dhe zbatimit në praktikë të ligjit. Në këto kushte, është përgjegjësi e Komisionerit që të ushtrojë kompetencat e tij në mënyrë të tillë që së pari të garantohet e drejta për informim e kërkuarit dhe më tej të shqyrtohet kundërvajtja administrative. Rrjedhimisht, konsiderohet e panevojshme që në ligj të parashikohet shprehimisht edhe radha e kryerjes së këtyre procedurave.

3.6 Sa i përket propozimit që të shtohet një në nenin 18/2 pas gërmës "nj" të shtohet gërma "o" me përmbajtje: *"mos ekzekutimi i vendimeve të Komisionerit sipas parashikimeve të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 150 000 deri në 300 000 lekë"* dhe që në nenin 19 përgjegjësia administrative t'i ngarkohet titullarit, sjellim në vëmendje se këto dispozita janë të parashikuara tashmë në projektligj.

3.7 Shoqëria civile ka propozuar që pika 6 e nenit 24 të riformulohet me përmbajtjen:

*"Në qoftë se Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale nuk merr vendim në afatin e parashikuar në pikën 4, të këtij neni, ankuesit i lind e drejta për t'iu drejtuar gjykatës. Në çdo rast, edhe pas kalimit të afatit të parashikuar në pikën 4 të këtij neni, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale duhet të shprehet mbi gjithçka që kërkohet në ankesën e paraqitur dhe të marrë vendim të*

arsyetuar” dhe që pas shkronjës pikës “a”, të pikës, 2 të nenit 9/1 të shtohet një pikë me përmbajtjen: “Komisioneri është i detyruar të dalë me vendim për çdo ankesë sipas pikës a) të pikës 2 të këtij neni.”

Në lidhje me këtë propozim theksojmë se e drejta e për t’iu drejtuar gjykatës lind që nga momenti që ka përfunduar afati i Komisionerit për të dalë me vendim mbi ankimin. Kjo çështje tashmë është zgjidhur përmes interpretimit të kryer nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i cili ka sqaruar se, në kushtet kur pala paditëse ka paraqitur ankim administrativ dhe organi publik nuk e ka marrë në shqyrtim ankimin edhe pas kalimit të afatit 30 ditor, paditësi i është drejtuar me padi gjykatës. Kolegji verën se palës paditëse i ka lindur e drejta për t’iu drejtuar rrugës gjyqësore për mbrojtjen e të drejtave, për sa kohë ky ankim nuk është shqyrtuar nga organi më i lartë. Çështja bën pjesë në juridiksionin gjyqësor. Këto përfundime janë në përputhje edhe me praktikën e unifikuar gjyqësore, sipas vendimeve nr. 1, datë 26.11.2010 dhe nr. 4, datë 30.05.2011, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, si dhe me praktikën aktuale të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë (shih vendimin 00-2020-17, datë 11.05.2020; vendimi 00-2020-19, datë 11.05.2020).

Sa më sipër, edhe në rast se Komisioneri nuk shprehet mbi ankimin brenda afatit të parashikuar, në saj të praktikës së mësipërme të KAGJL, kërkuesit i lind e drejta për t’iu drejtuar gjykatës, pa pasur nevojë të presë që Komisioneri të shprehet mbi ankimin. Për më tepër, konsiderohet se është e panevojshme që Komisioneri të marrë vendim pas kalimit të afatit të sipërcituar për shkak se nuk do t’i sjelle ndonjë dobi kërkuesit, i cili tashmë i është drejtuar gjykatës dhe për më tepër një vendim i tillë, përtej afatit të përcaktuar në ligj, do të ishte një vendim i marrë në kushtet e shkeljes së procedurës.

3.8 Në lidhje me pikën 1, të nenit 9, sipas së cilës në fund të pikës 1, shtohet një fjali sipas së cilës përpara dhënies së informacionit të kërkuar, autoriteti publik njofton titullarin e këtyre të drejtave, janë përcjellë komentet si vijon:

- “Njoftimi i titullarit do të çënojë dhe do të rrezikojë punën dhe integritetin fizik të kërkuesit, veçanërisht të gazetarëve investigativë. Vënia në dijeni se një gazetar po heton mbi një çështje të caktuar e dëmton hetimin, duke ekspozuar punën e gazetarit, përpara se ai të përfundojë hetimin. Lidhur me të drejtat e titullarit, bëhet fjalë për ato të cilat i referohen jetës private, sekretit tregtar, patentat, të drejtat e autorit. Si gazetarë, ne nuk legjitimohemi për t’i pasur këto të drejta, kësisoj kërkesat e paraqitura prej nesh nuk synojnë këtë territor. Ne



nuk legjitimohemi për të disponuar të dhëna personale, apo sekrete tregtare. Autotiteti publik mund të njoftojë, vend e pa vend, "titullarët" e këtyre të dhënave dhe amendimi në fjalë nuk jep asnjë garanci se në ç'mënyrë do të ndodhë kjo gjë në praktikë. Nga frika e dekonspirimit, gazetari mund të tërhiqet nga kërkesa dhe kjo gjë do të ndikojë, drejtpërdrejt, raportimin. Nga ana tjetër, është jashtëzakonisht e mundur që autoriteti publik të mos jetë në gjendje që të bëjë siç duhet testin e interesave publike, çka do të dekonspirojë gazetarin dhe punën e tij. Njoftimi "i titullarit" të të drejtave është edhe një ndërhyrje në punën e gazetarëve, pasi në këtë mënyrë shteti ndërhyr në të drejtën dhe në përgjegjësinë e medias për vetrregullim. Çështja e të dhënave personale është njëkohësisht një çështje etike. Trajtimi i këtyre të fundit nën diktatin e shtetit, ua suprimon gazetarëve këtë të drejtë dhe njëkohësisht, përgjegjësi. Autoriteti nuk mund të marrë atributet e media-s. Njoftimi i palëve është pjesë e deontologjisë së punës së gazetarëve, jo e autoritetit shtetëror"

- Kjo dispozitë krijon një pengesë artificiale dhe të panevojshme që kufizon të drejtën për informim në mënyrë jo proporcionale. Kjo duke patur parasysh që praktika tregon që pjesa dërrmuese e rasteve refuzohet informacioni me qëllimin e mbrojtjes së të dhënave personale, sekretit tregtar, të drejtës së autorit. Autoriteti publik ka detyrë të bëjë vetë balancën e proporcionalitetit, ndaj përfshirja e të tretëve te ky vlerësim i Autoritetit është i tepërt dhe i dëmshëm, sepse ky parashikim sjell si pasojë dy problematika:

Në rast se informacioni kërkohet për një investigim eventual nga një organizatë apo gazetar, vënia në dijeni e mbajtësit të të dhënave, do të krijonte mundësi potenciale që ky i fundit të vepronte/reagonte, qoftë edhe në mënyra të paligjshme, për të penguar investigimin. Puna e gazetarit investigues është e një natyre delikate dhe si rregull zhvillohet në mënyrë të fshehtë në momentet e para të hulumtimit dhe mbledhjes së të dhënave. Pasi gazetari i siguron të dhënat, ai/ajo kontakton personin për marrjen e mendimit/qendrimin mbi faktet që do të publikohen në artkull. Vënia në dijeni zyrtarisht në një fazë të hershme të investigimit, që një gazetar po interesohet për një dokument, krijon premisat e një efekti frenues të lirisë së medias.

- Nëse kjo dispozitë do të mbetet si më sipër, njoftimi do të afektojë afatin 10 ditor të kthimit të përgjigjes. Lidhur me këtë problem, konstatojmë se draftit i mungojnë afatet se brenda sa ditësh do të duhet të njoftohen mbajtësit e të drejtave dhe brenda sa ditësh ata do të mund të kthejnë përgjigje. Lidhur me

*këtë problem, sugjerojmë një ndarje të afateve, pa cënuar afatin ligjor (10 ditor), për shembull:*

- *caktimin e një afati 2 ditor për njoftimin e mbajtësit të të drejtave;*
- *caktimin e një afati 5 ditor për kthimin e përgjigjes nga mbajtësi i të drejtave, dhe;*
- *caktimin e një afati 3 ditor për trajtimin final të kërkesës për informacion.*

Bazuar në komentet e mësipërme, si dhe duke vlerësuar shqetësimin e komunitetit të gazetarisë dhe medias, dispozita është hequr nga përmbajtja e projektligjit.

3.9 Në lidhje me kompetencën e Komisionerit për të bërë rekomandime për autoritetet publike, lidhur me konceptimin dhe zbatimin e programeve institucionale të transparencës është përcjellë komenti se shpesh, në praktikë, dhënia e rekomandimeve mund të paralizojë vendimmarrjen dhe akoma më keq, ka rezultuar në mosdhënie të informacionit të kërkuar. Nga ana tjetër, promovimi i rekomandimeve ka shumë mundësi që të zbehë fuqinë vendimmarrëse të Komisionerit, duke i zëvendësuar vendimet me rekomandime, të cilat, këto të fundit nuk do të rezultojnë, domosdoshmërisht, në favor të hapjes. Ndaj sugjerimi është që kjo klauzolë të ndryshohet si më poshtë:

*"Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale... bën rekomandime për autoritetet publike, lidhur me konceptimin dhe zbatimin e programeve institucionale të transparencës, kur rekomandimi i shërben bërjes së informacionit të vlefshëm për publikun".*

Në lidhje me këtë koment theksohet se rekomandimet në lidhje me programin e transparencës synojë që të orientojnë autoritetet publike në lidhje me zbatimin sa më të mirë të programit dhe konceptimin e tyre në mënyrë të tillë që t'i shërbejë publikimi të një game sa më të gjerë informacioni. Pavarësisht dhënies së këtyre rekomandimeve, kompetenca e Komisionerit për të shqyrtuar ankimet në lidhje me programet e transparencës mbetet e pandryshuar dhe nuk cenohet nga dhënia e rekomandimeve.

3.10 Komiteti Shqiptar i Helsinkit ka propozuar që në pikën 3, që i shtohet nenit 4, të shtohen fjali në lidhje me afatin që kanë në dispozicion autoritetet e reja publike për publikimin e programit të transparencës, i cili duhet të përkohë me afatin 6 mujor të parashikuar në pikën 1, të nenit 4.



Sa i takon këtij komenti theksojmë se në pikën 1, të nenit 4, ligji ka parashikuar që autoritetet publike të vënë zbatim programin e transparencës brenda 6 muajve nga krijimi i tyre dhe në këto kushte vlerësohet i panevojshëm shtimi i një pikë që sjell përsëritje të dispozitave.

3.11 Gjithashtu, KSHH sugjeron që në pikën 1, pas togfjalëshit bëhet publik të shtohet një togfjalësh që mundëson publikimin e Programit të Transparencës në hapësira lehtësisht të aksesueshme dhe në mënyrë të kuptueshme për publikun e gjerë, në faqet zyrtare të autoritetit publik.

Në lidhje me këtë koment sqarojmë se publikimi në hapësira lehtësisht të aksesueshme dhe në mënyrë të kuptueshme për publikun e gjerë, është i parashikuar në shkronjën “a”, të pikës 2, të nenit 4, si dhe në pikën 1, të nenit 7.

3.12 KSHH propozon që në pikën 1, shkronja “c”, fjalët “ankimit të vendimit përkatës” të zëvendësohen me fjalët “ankimit të vendimit përkatës apo çdo mjeti ligjor administrativ për kundërshtimin e tij” dhe jo me fjalët “ushtrimit të mjeteve ligjore administrative”. Kjo për shkak se në aspektin e kuptueshmërisë e rrjedhimisht të parimit të qartësisë, shprehja “ankimit të vendimit përkatës” është më orientuese për shtetasit dhe publikun e gjerë.

Në lidhje me këtë koment sqarojmë se fjalët “ushtrimit të mjeteve ligjore administrative” përfshijnë të gjitha mjetet ligjore në dispozicion të kërkuesit të parashikuara nga Kodi i Procedurave Administrative. Sa i takon kuptueshmërisë, së këtij termi, sqarojmë se është detyrimi i organeve publike që të shtjellojnë në mënyrë të zgjeruar kuptimin e këtij termi në mënyrë të tillë që të jetë më i qartë për publikun, duke përfshirë si ankimin administrativ, ashtu edhe mjetet e tjera ligjore. Një rol të rëndësishëm në lidhje me këtë çështje luan edhe Komisioneri i cili mund të parashikojë një format standard të shpjegimeve përkatëse, në kuadër të miratimit të programeve model të transparencës sipas nenit 6 të ligjit.

3.13 Gjithashtu, KSHH propozon që në ligj të zgjerohet dhe saktësohet gama e informacionit që bëhet publik pa pagesë nga institucionet. Sipas tij, *“termi “akte nënligjore” është disi kufizues pasi mund të ketë edhe akte të tjera me rëndësi për publikun që nuk janë akte nënligjore si aktet normative apo aktet administrative individuale. Një prej tyre janë edhe Rregulloret e Brendshme të Institucioneve. Në mënyrë të veçantë për institucionet dhe organet kolegjiale, faqet duhet të sigurojnë transparencë për të njohshuar zhvillimet e mbledhjeve të*



*këtyre organeve dhe natyrën e vendimeve të marra, sikurse mund të jenë me interes mbledhjet e Këshillave Bashkiakë apo edhe institucioneve të tjera.”.*

Në lidhje me këtë koment sqarojmë se termi akte nënligjore përfshin në vetvete si akte nënligjore normative, ashtu edhe aktet nënligjore administrative (kolektive dhe individuale). Autoritetet publike kanë detyrimin të publikojnë të gjitha ato akte të cilat janë me rëndësi për publikun pasi përfshihen në një nga kategoritë e informacionit të parashikuara në pikën 1 ose 3 të nenit 7.

Rregulloret e brendshme të autoriteteve publike janë të detyrueshme për t'u publikuar në Programin e Transparencës, sipas urdhrit nr. 187 datë 18.12.2020 Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale “Për miratimin e Programit të Transparencës të Rishikuar”, të ndryshuar, në kategorinë “Kuatri ligjor rregullator”. Në këto kushte, parashikimi shprehimisht i detyrimit për publikimin e saj nuk është i nevojshëm pasi është një praktikë që tashmë është vendosur nga Komisioneri dhe përmbushja e këtij detyrimi lidhet zbatimin në praktikë të urdhrit të sipërcituar.

Ndërkohë, edhe publikimi i informacionit mbi zhvillimet e mbledhjeve të organeve kolegjiale dhe natyrën e vendimeve të marra, është një detyrim i cili buron nga shkronjat “b”, “d”, “f”, “j”, “k” dhe “l”, të pikës 1 dhe pika 2 e nenit 7. Në këto kushte, publikimi i tyre është një çështje që lidhet me zbatimin e ligjit dhe jo me mangësi në parashikimin e këtyre kategorive të informacionit.

3.14 Në lidhje me kompetencat e Komisionerit të parashikuara në nenin 9/1, KSHH sugjeron që:

Në shkronjën “d” në vijim të togfjalëshit “nga interesa të rëndësishme shtetërore” të shtohet edhe togfjalëshi “ose të interesit të lartë publik”, për arsye se, deklasifikimi, nëse nuk cenon parimet e legjislacionit në fuqi dhe përbën një informacion me interes të lartë për publikun, do të ishte një kriter i rëndësishëm në funksion të arritjes së qëllimit të synuar, si një kompetencë që i ngarkohet Komisionerit nëse do të çmohet prej tij.

Në lidhje me këtë koment, sqarojmë se rastet e deklasifikimit të informacionit dhe shkaqet për deklasifikimin e tij janë të parashikuara nga ligji nr. 10/2023 “Për informacionin e klasifikuar”. Në shkronjën “c”, të pikës 2, të nenit 22, të projektligjit “Për informacionin e klasifikuar”, është parashikuar që informacioni mund të deklasifikohet kur publikimi i tij diktohet nga interesa më të rëndësishme shtetërore, sesa nevoja për ta mbajtur atë të klasifikuar. Sa më

sipër, shkronja “d”, e pikës 2, të nenit 9/1, është hartuar në mënyrë të tillë që të jetë në harmoni me dispozitat e ligjit për informacionin e klasifikuar. Gjithashtu, theksojmë se fjalët “interesa më të rëndësishme shtetërore”, përfshijnë edhe interesin publik, si dhe Komisioneri do të ushtrojë këtë kompetencë në përputhje me parashikimet e pikës 2, të nenit 17, ku parashikohet se informacioni i kërkuar nuk refuzohet në rast se ekziston një interes publik më i lartë për dhënien e tij.

KSHH ka propozuar që pas shkronjës “dh”, të shtohet një shkronjë tjetër me përmbajtje *“urdhëron organin publik të vendosë në dispozicion të ankuesit informacionin e kërkuar, plotësisht ose pjesërisht, nëse vendimmarrja e Komisionerit është përfundimtare apo nuk është pezulluar”*.

Sa i përket këtij sugjerimi, sqarojmë se kjo kompetencë është parashikuar tashmë në shkronjën “b”, të pikës 5, të nenit 24 të ligjit në fuqi.

Për kompetencën e Komisioneri për të kryer sondazhe në lidhje me çështje të ndryshme që kanë të bëjnë me të drejtën e informimit, KSHH sugjeron që sondazhet të kryhen mbi baza vjetore, sugjerim i cili është pranuar.

Në lidhje me propozimin që sanksionet administrative duhet t’i jepen autoritetit publik dhe më pas ky i fundit me padi regresi të kërkojë shlyerjen e gjobës nga ana e punonjësit përgjegjës për mosdhënien e informacionit, vlejné të njëjtat argumente të dhëna për komentin e Bankës së Shqipërisë në lidhje me këtë çështje.

3.11 Duke qenë se në pikën 1, të nenit 17, parashikohej që të shtohej një fjali sipas së cilës përpara dhënies së informacionit të kërkuar, autoriteti publik njofton titullarin e të drejtave, KSHH ka propozuar që, me qëllim që ky parashikim mos të bëhet pengesë në rastet kur titullari i së drejtës nuk mund të njoftohet objektivisht, të qartësohet “pamundësia objektive e njoftimit” në këtë shtesë.

Në lidhje me këtë çështje bëjmë me dije se shtesa në pikën 1 është hequr.

3.12 Sa i përket nenit 10, KSHH ka përcjellë komentin se dënimet me gjobë duhet të jenë të drejta dhe proporcionale, ndaj ulja e tyre mund të krijojë efekte të mëtejshme tkurrëse në nevojën për zbatim efektiv të ligjit për të drejtën e informimit. Gjithashtu, këto ndryshime nuk bazohen në ndonjë studim apo analizë mbi eksperiencën e deritanishme të zbatimit të ligjit dhe pasojat financiare të shkaktuara ndaj koordinatorëve për të drejtën e informimit.

Në lidhje me këtë koment sqarojmë se qëllimi i ndryshimit të masës së sanksioneve administrative është pikërisht që ato të jenë të drejta dhe proporcionale (argumentet më të zgjeruara gjenden në seksionin e tretë të këtij relacioni). Sa i përket studimeve dhe analizave, theksojmë se ndryshimet në këtë nen janë propozuar nga Komisioneri, i cili me shkresën nr. 1243/1 prot., datë 13.07.2022, ka sqaruar se propozimi vjen për shkak se nga zbatimi në praktikë, ka rezultuar se për koordinatorë të caktuar të autoriteteve publike, vlcra e sanksionit vendosur ndaj tyre, nuk është proporcionale.

3.13 KSHH vlerëson se duhet të parashikohet qartazi shkelje administrative, mosdhënia apo refuzimi, plotësisht apo pjesërisht i informacionit brenda afateve dhe kërkesave të parashikuara në ligj. Në lidhje me këtë sugjerim, sqarojmë se krahas shkeljeve administrative të parashikuara nga ligji në fuqi, në projektligj parashikohet shtimi i shkronjave “m” deri “o”, të cilat synojnë të ngarkojnë me përgjegjësi çdo person që shkel ligjin.

3.14 Sa i përket pikës 6/1, që i shtohet nenit 24, KSHH vlerëson se vendosja e saj në këtë nen është e papërshtatshme dhe propozon që të shtohet neni 20/1 me titull “Vendimet e Komisionerit” ku sugjeron që të parashikohet shprehimisht se vendimet e Komisionerit janë tituj ekzekutiv, me përjashtim të rasteve kur gjykata vendos pezullimin e tyre, si dhe që Komisioneri të urdhërojë autoritetin publik të japë informacionin e kërkuar, në mënyrë të plotë ose të pjesshme, apo të zbatojë detyrime të tjera ligjore sipas parashikimeve në nenin 18 të ligjit.

Në lidhje me sugjerimin që vendimi i Komisioneri të parashikohet si titull ekzekutiv, sillet në vëmendje se vendimi i Komisionerit është akt administrativ dhe ekzekutohet në përputhje me parashikimet e pjesës së tetë të Kodit të Procedurave Administrative. Sa i përket parashikimit që Komisioneri të urdhërojë autoritetin publik të japë informacionin e kërkuar, në mënyrë të plotë ose të pjesshme, apo të zbatojë detyrime të tjera ligjore sipas parashikimeve në nenin 18 të ligjit, sillet në vëmendje se kjo kompetencë është parashikuar tashmë në shkronjën “b”, të pikës 5, të nenit 24 të ligjit në fuqi.

3.15. Në lidhje me komentin për nenin 24/2 mbi kërkesat abuzive, bëjmë me dije se ky nen është hequr nga përmbajtja e projektligjit.

Qendra Shkencë dhe Inovacion për Zhvillim (SCiDEV) ka përcjellë komentin si më poshtë vijon:



3.17 *Vlerësojmë që disa nga sugjerimet e shoqërisë civile janë marrë parasysh. Sugjerimet që të ndryshohen dispozitat për 'kërkesat abuzive' pasi nuk e përmirësojnë situatën me transparencën e autoriteteve publike. Gjithashtu, të parashikohet në ligj mundësia për të ekzekutuar forcërisht vendimet e Komisionerit për të Drejtën e Informimit. Komisioneri për të Drejtën e Informimit duhet të marrë vendim për çdo ankese, duke shmangur "zgjidhjet me ndërmjetësim" dhe/ose refuzimet mes shkresave të nëpunësve të tij pa delegim kompetencë.*

Në lidhje me çështjet e ngritura në koment, vlejné të njëjtat argumente të dhëna më sipër.

3.18 Qendra "Faktoje" ka propozuar që në nenin 17 të shtohen si pjesë të kategorive të informacionit që bëhen publikë pa pagesë edhe pasqyrat e shpenzimeve të titullarit dhe delegacionit të tij në udhëtime jashtë vendit, si dhe pasqyrën e shpenzimeve të institucionit për spote/reklama televizive.

Në lidhje me këtë propozim sillet në vëmendje se ligji përmban kategori të veçanta informacioni që në përgjithësi i shërbejnë interesit publik në tërësi dhe jo kategori specifike të informacionit/dokumentacionit. Pikërisht për këto arsye, ligji parashikon publikimin e disa informacioneve me rëndësi të veçantë dhe që i shërbejnë interesit publik në Programin e Transparencës dhe pjesa tjetër e informacionit t'i vendoset në dispozicion kërkuarit përmes kërkesave për informacion. Parashikimet aktuale, si dhe ndryshimet e propozuara garantojnë një zbatim më të mirë të ligjit dhe transparencë më të gjerë të autoriteteve publike duke përfshirë edhe një zbatim më të mirë të mekanizmit të kërkesave për informacion.

3.19 Sa i përket masave të sanksioneve administrative qendra "Faktoje" shprehet se: *"Duke marrë parasysh që ligjvënësi kërkon uljen e vlerës së dënimit për institucionet që nuk dorzojnë informacionin sipas ligjit dhe duke marrë parasysh vështirësitë që ekzistojnë tashmë për të marrë informacionin, gjykojmë që zvogëlimi i dënimit do e ulë numrin e përgjigjeve të dhëna në kohë. Për këtë propozojmë që pas vendimit të Komisionerit për të Drejtën e Informimit që detyron institucionin të kthejë përgjigje, në rastet kur institucioni tejkalon afatin, përpos dënimit të përcaktuar në shkronjën "o" të nenit 18, të parashikohet një kamatvonesë ditore për mos dhënien e informacionit sipas ligjit. Pas shkronjës "o" shtohet shkronja "o/1" me përmbajtjen si vijon: "0/1 masa e dënimit shtohet me 10 000 lekë për çdo ditë që kalon nga afati për*



*zbatimin e vendimit të Komisionerit kur ka urdhëruar dhënien e informacionit të kërkuar, në mënyrë të plotë ose të pjesshme.”.*

Në lidhje me këtë sugjerim vlerësohet se masa e gjobës, si në kufirin minimal ashtu edhe në atë maksimal është e tillë që të garantojë si ndëshkimin e shkeljeve, ashtu edhe parandalimin e kryerjes së të njëjtës shkelje në të ardhmen. Gjithashtu, në përcaktimin e kësaj mase është treguar vëmendje që masa e sanksionit të jetë mjaftueshëm e rëndë që titullari i autoritetit publik të ndërmarrë të gjitha masat për të siguruar zbatimin e vendimit të Komisionerit. Vendosje e një shtese prej 10 000 lekësh për çdo ditë që kalon nga afati për zbatimin e vendimit të Komisionerit, nuk vlerësohet si masë e përshtatshme dhe proporcionale.

## **VIII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT**

Institucionet dhe organet që ngarkohen për zbatim janë të gjithë autoritetet publike sipas përkufizimit aktual të ligjit për të drejtën e informimit, si dhe Komisioneri.

## **IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE**

Projektligji parashikohet të ketë efekte financiare në buxhetin e shtetit për shkak se parashikohet përfitimi i një shtese mbi pagë për natyrë të veçantë pune për koordinatorët për të drejtën e informimit. Duke patur parasysh numrin aktual të autoriteteve publike, rreth 380, (nga të cilat jo më shumë se 350 prej tyre janë me financim nga buxheti i shtetit), në raport me shtesën mbi pagë për koordinatorin për të drejtën e informimit (vlerësohet në masën 10 000 lekë/muaj), efektet financiare për çdo autoritet publik do të jenë në masën 140 mijë lekë në vit dhe me një efekt financiar për buxhetin e shtetit në total prej jo më shumë se 49 milion lekë. Kjo shtesë page do të përcaktohet me Vendim të Këshillit të Ministrave sipas legjislacionit në fuqi.

**MINISTRI**

**ULSI MANJA**

